



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Nr.822/12. Prot.

Tiranë, më 26 /02 / 2017

V E N D I M

Nr.11, Datë 26/02/ 2017

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE, TIRANË ME OBJEKT: “AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE PËR PERIUdhËN 07.09.2014 DERI NË 31.08.2016”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit dhe Zbatimit të Standardeve dhe etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “Zbatimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të AKBN për periudhën 07.09.2014 deri në 31.08.2016”.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

I. MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMI E AKBN

A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në auditimin e mëparshëm pranë AKBN, kemi ngritur problemin e formës së organizimit dhe funksionimit të këtij Institucioni, problematikë që konstatohet edhe në këtë auditim. Nga AKBN, nuk është marrë asnjë masë për të kërkuar saktësimin e statusit të funksionimit të saj, sic është kërkuar nga KLSH. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është institucion, i ngritur në zbatim të VKM nr.547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore”. Neni 1 përcakton “Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

(AKBN), si institucion në varësi të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me seli në Tiranë”. Ndërkohë në nenin 4 “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është ent publik, i krijuar nga bashkimi i Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve, Institutit të Studimeve dhe Projektive të Metalurgjisë, Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve dhe Institutit të Studimeve dhe Projektive të Mekanikës dhe Drurit”. Pra kjo agjenci krijohet si ent publik, në varësi të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës sot Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë. Sipas Vendimit të krijimit Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për shërbimet që ofron, financohet nga Buxheti i Shtetit, nëpërmjet projekteve, përcaktim që gjendet në nenin 5. Në momentin e krijimit fondet janë alokuar nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Në statut rregulloren e miratuar në vitin 2009, në nenin 4 jepet një përkufizim më i gjerë se përcaktimi i VKM nr.547, datë 09.08.2006, me të cilën u krijuar ky ent publik. Kështu citojmë “AKBN, për shërbimet që ofron, financohet nga buxheti i shtetit nëpërmjet projekteve dhe siguron të ardhurat e tjera, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj”.

Për periudhën objekt auditimi, AKBN ka funksionuar sipas Statut rregullore së funksionimit të AKBN-së, të miratuar nga ministri me urdhërin nr.75, datë 01.02.2013, i ndryshuar, me urdhërin nr.128, datë 20.03.2014 dhe me urdhërin nr.226, datë 05.10.2015 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në statut-rregulloren e funksionimit të AKBN-së”.

Në nenin 20 është përcaktuar se *“Planifikimi i treguesve për projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit dhe zbatimi i tyre, do të bëhet konformë Ligjit nr.8379, datë 21.07.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në RSH” dhe akteve ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim, për çdo vit kalenderik. Për të gjithë veprimtarinë e saj ekonomike-financiare, AKBN përgatit programin ekonomik për çdo vit kalendarik, në përputhje me udhëzimin e METE për këtë qëllim”.* Konstatohet se referimi ligjor i këtij ligji është i gabuar pasi Ligji nr.8379, datë 21.07.1998 është shfuqizuar me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”. Ndërkohë që neni 22 bën plotësime shtesë në burimet e financimit të aktivitetit të AKBN, duke përfshirë *“projektet e financuara nga buxheti i shtetit, projekte dhe shërbime për të tretë, administrimi i të dhënave, bonuse dhe fondet, kualifikim-administrim, nga marrëveshjet hidrokarbure, shitja e pjesës së shtetit në një marrëveshje hidrokarbure, interesat bankare, donacione dhe burime të tjera të ligjshme”.*

AKBN është krijuar si një ent publik që financohet nga buxheti i shtetit dhe projekte të tjera, por konstatohet se kjo agjenci është jashtë kontrollit buxhetor pra ajo nuk kryen veprime përmes llogarive të thesarit të shtetit, si dhe nuk dorëzon pasqyrat financiare sipas rregullave të enteve publike në thesar. Faktikisht ajo vijon të funksionojë si një shoqëri tregtare me kapital shtetëror. Në këto kushte, fondet e përdorura nga AKBN, për periudhën e audituar në vlerën 434,176 mijë lekë për vitin 2014, në vlerën 393,136 mijë lekë për vitin 2015 dhe 326,557 mijë lekë për vitin 2016, janë bërë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” (trajtuar më hollësisht në faqen 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN dhe MEI në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të realizojë vendosjen e këtij institucionin nën regjimin buxhetor sipas kërkesave të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, duke kërkuar që transaksionet financiare të kalojnë përmes sistemit të thesarit. Kjo do të sigurojë edhe një nivel të shtuar kontrolli mbi mënyrën e sigurimit të të ardhurave për funksionimin e institucionit.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Në Republikën e Shqipërisë, pagat e punës dhe shpërblimet e punonjësve të gjithë kategorive, rregullohen me Ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për Kompetencat për Caktimin e Pagave dhe të Shpërblimeve”, ku sipas gurmës “ç” të nenit 2, kanë kompetenca për caktimin e pagave, “*organet kolegjiale drejtuese të njësisve të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore, shoqërive aksionare dhe të institucioneve të tjera publik;*” dhe sipas nenit 6, pika 1, germa “a”, organet kolegjiale drejtuese miratojnë; “*nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimalë caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mendësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.*” Bazuar në nenin 7, të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e tij, përkatësisht vendimet për pagat e nëpunësve civil, të ndërmarrjeve shtetërore, të shoqërive aksionare dhe të institucioneve të tjera publike duke përcaktuar kufirin minimal dhe maksimal mbi të cilat **duhet ndërtuar struktura e pagave në varësi të mundësive të tyre financiare.**

Këshilli Drejtues i AKBN-së për përcaktimin e struktura e pagave është bazuar në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet Ligjit nr.9584, datë 17.07.2006 “Për Pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe të Institucioneve të Tjera të Pavarura, të Krijuara me ligj”, duke përcaktuar raportin e pagave të funksionarëve të larta, në raport me pagën e Presidentit të Republikës. Cilësojmë edhe njëherë nenin 4 “*Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është ent publik..*” në varësi të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës sot Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë.

Referenca e përdorur nga Këshilli Drejtues i AKBN, duke e barazuar këtë institucion me një institucion të pavarur apo kushtetues, është jo vetëm e gabuar por ka pasoja negative në programin ekonomik-financiar dhe rezultatin financiar të këtij enti publik. Sipas VKM nr.930, datë 29.12.2014, pika 7, “*Funksionimi, struktura organizative dhe struktura e pagave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore përcaktohen në statut rregulloren e kësaj agjencie, e cila miratohet me urdhër të ministrit të Energjisë dhe Industrisë. Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen në bazë të Kodit të Punës*” (trajtuar më hollësisht në faqen 38-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli i Drejtimit të AKBN në bashkëpunim me MEI-së të përcaktojë një struktura të re të pagave e punës, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave për institucionet e varësisë të MEI-së, bazuar në kërkesat e Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011“Për Kompetencat për Caktimin e Pagave dhe të Shpërblimeve” .

Menjëherë

2. Nga auditimi i realizimit të buxheteve, kemi konstatuar se programimi buxhetor vjetor është prekur nga ndryshime gjatë vitit buxhetor deri në tre herë, fakt që tregon për një proces jo të kujdesshëm nga ana e AKBN. Nga auditimi u konstatua programimi i shumës prej **127,807 mijë lekë**, për të përballuar pagesën e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna që kanë fituar proceset gjyqësore me AKBN, ndërkohë që sipas të dhënave të Drejtorisë Ekonomike rezultojnë se për periudhën objekt auditimi AKBN ka një detyrim për të paguar në shumën 35,506,510 lekë për 35 punonjës, çka tregon se planifikimi është me rezerva. Për këtë periudhë konstatuam se janë paguar pa nxjerrë përgjegjësinë për personat përgjegjës që kanë lejuar shkeljen e dispozitave ligjore të kodit të punës në largimet nga puna, shuma **35,506,510 lekë** (respektivisht për vitin 2014 në shumën 22,429,440 lekë, për vitin 2015 në shumën 10,080,804 lekë dhe për 8/mujorin e

vitit 2016 në shumën 2,999,265 lekë), vlerë që ka ndikuar negativisht në buxhetin e shpenzimeve të institucionit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike e AKBN-së të paraqesin tek Drejtori Ekzekutiv dhe në Këshillin Drejtues të AKBN një raport të hollësishëm për të gjitha rastet e largimit nga puna duke përcaktuar edhe përgjegjësitë e punonjësve të administratës që kanë lejuar shkeljen e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës duke i larguar punonjësit padrejtësisht nga puna.

Menjëherë

3. Nga auditimi u konstatua se gjatë aktivitetit të saj AKBN, ka hyrë në marrëdhënie huamarrje me Albpetrol sh.a, marrëdhënie që bie në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH si dhe VKM nr.547, datë 09.08.2006, i ndryshuar, me VKM nr.930, datë 29.12.2014, pika 1, ku përcaktohet se: “AKBN, nuk financohet nga buxheti i shtetit, por ka të drejtë të përfitojë projekte të financuara nga buxheti i shtetit apo nga subjekte të tjera”. Kështu nga auditimi u konstatua se AKBN ka programuar dhe ka realizuar **32,000 mijë lekë** të ardhura nga marrja e një huaje nga shoqëria shtetërore Albpetrol sha. Sipas Drejtorisë Ekonomike kjo hua është marrë në fillim të vitit 2014, për të përballuar vështirësitë financiare të hasura gjatë muajve janar e shkurt 2014, ndërkohë deri në fund të afatit të këtij auditimi rezulton të jetë shlyer vetëm shuma 5,000 mijë lekë e kësaj huaje. Sipas pasqyrave financiare të AKBN dhe dokumentacionit vënë në dispozicion, rezulton se është nënshkruar edhe një marrëveshje tjetër huaje me Albpetrolin në vitin 2011 për shërbimin e konsulencës së “Paton Boggs-it” në vlerën **15,300 mijë lekë**, ndërkohë që në debi të llogarisë “Debitorë, kreditor të tjerë” me emërtimin “Albpetrol paguar oponenta nga AKBN” është raportuar shuma 11,743,434 lekë dhe në kredi, në llogarinë “Huamarrje afatshkurtër”, është raportuar shuma 27,000,000 lekë. Sipas akt rakordimeve me Albpetrolin konstatohet se detyrimi i mbetur është 11,700,000 lekë ndërkohë që kontabilisht vlera reflekton një diferencë prej 3,556,566 lekë. Si ent publik shtetëror nuk mund të parashikojë dhe as të realizojë të ardhura dhe shpenzime me burim hua të ndryshme shtetërore apo private, pa marrë pëlqimin e Ministrisë së Financave, *(trajtuar më hollësisht në faqen 32-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike e AKBN të verifikojë të gjitha veprimet kontabile të kryera për të dy marrëveshjet e huas, të bëjë rregullimet e duhura në kontabilitet për diferencën prej 3,556,566 lekë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të saktësojë marrëdhënien dhe ecurinë e pagesave për të shlyer këto detyrime.

Menjëherë

4. Nga auditimi i pasqyrave financiare të paraqitura dhe dokumentacionit mbështetës, kemi konstatuar pasaktësi të lidhura me pozicione të caktuara të detyrimeve. Kështu në pasqyrat financiare të vitit 2015, AKBN ka paraqitur në aktiv të bilancit vetëm 29,758,467 lekë në rubrikën “Të drejta të arkëtueshme” në llogarinë “Debitor kreditor të tjerë”, nga të cilat “Debitor të trashëguar nga AKH” shuma **4,818,070 lekë**, çka tregon se llogaritë e aktivit të bilancit nuk pasqyrojnë gjendjen reale të aktiveve të tjera financiare afatshkurtra. Nga të dhënat e Drejtorisë Ekonomike, rezulton një kërkesë për arkëtimin e detyrimeve nga KESH sh.a në vlerën prej 189,000 mijë lekë, që bazohet në një urdhër të Ministrit të Ekonomisë dhe Privatizimit nr.343, datë 16.07.2001 “Për mbështetjen financiare të KESH sh.a”. Ky detyrim nuk është pasqyruar në

regjistrat e kontabilitetit të AKBN pas bashkimit të katër institucioneve, si dhe nuk evidentohen si, detyrime të tjera financiare, në asnjërin nga bilanci dhe pasqyrat financiare të përgatitura pas bashkimit në vitin 2006 të AKH, ISPM, ITNPM dhe ISPMD, në zbatim të pikave 4, e 6, të VKM nr.547, datë 9.8.2006.

Sipas ditarit të bankës, rezulton se AKBN ka arkëtuar nga KESH sh.a, në llogarinë e saj në B C deri më 31.08.2016, shumën 140,000,000 lekë si “*Debitor, kreditor të tjerë*” me analizë “*KESH SHA, për Debitor të trashëguar nga AKH*” (trajtuar më hollësisht në faqen 32-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Sektori i Financës të bëjë verifikimet e nevojshme për të gjitha veprimet kontabël të kryera në lidhje me detyrimin fillestar prej 200 milion lekë që KESH sh.a kishte ndaj AKH para vitit 2006, arkëtimet e realizuara deri tani nga AKBN dhe veprimet e kryera në kontabilitet duke bërë sistemimet përkatëse në përputhje me rregullat për mbajtjen e kontabilitetit.

Audituesi i jashtëm i pavarur të verifikojë dhe certifikojë, shifrën e sistemuar në pasqyrat financiare të vitit 2016.

Menjëherë

5. Nga shqyrtimi i strukturës organike dhe ndërtimi i saj sipas drejtorive dhe sektorëve krahasuar me përshkrimet e bëra për çdo pozicion pune, konstatohen se nuk janë përcaktuar përshkrimet e punës për disa pozicione pune. Pavarësisht nga disa kompetenca të përcaktuara në Statut-rregullores e funksionimit të AKBN-së, është e nevojshme që edhe për këto funksione të përcaktohen në mënyrë analitike detyrat dhe përgjegjësitë individuale. Në përshkrimet e punës për çdo pozicion konstatuam dublime të përgjegjësive për sektor dhe pozicione të ngjashme si dhe, numër të lartë punonjësish në raport me detyrat funksionale që mbulojnë. Në Statut-rregulloren e funksionimit të AKBN, në rregulloren e brendshme dhe as në dokumentin e hartuar për përshkrimet e punës për çdo pozicion pune, të hartuara dhe të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe ministri i MEI-it, nuk janë përcaktuar përgjegjësitë menaxheriale të Drejtorit ekzekutiv njëherësh edhe nëpunës autorizues dhe koordinator i riskut, të nëpunësit zbatues dhe të menaxherëve të tjerë të njësisë publike, në kundërshtim me kërkesat e neneve 3,8,9,10,11 dhe 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqen 38-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga AKBN rishikimi i strukturës organizative të institucionit të shoqërohet me përpunim të dokumentit që përcakton përshkrimin e punës së punonjësve, duke synuar jo vetëm përshtatjen me strukturën e re të miratuar por edhe plotësimin me detyrat dhe përgjegjësitë që parashikon Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Vëmendje duhet ti kushtohet eliminimit të dublimit të detyrave dhe përgjegjësive dhe shkurtimeve e atyre sektorëve apo pozicioneve të punës që konsiderohen pa vlerë të shtuar, duke vënë në rrezik efektivitetin në përmbushjen e funksioneve që ka ky ent publik.

Menjëherë

6. Nga auditimi në lidhje me funksionimin e Grupit për kryerjen e oponencës teknike (OT) të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion, konstatohet se në cilësinë e Kryetarit të Grupit të Oponencës është Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, tagër që rrjedh nga neni 3/3 i Rregullores “Për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me

koncesion në AKBN”. Referuar 2 akteve nënligjore si Statut rregullore së AKBN-së, neni 13/1 si dhe Rregullore “Për funksionimin e Këshillit Teknik të AKBN-së”, neni 3, Drejtori Ekzekutiv rezulton të jetë njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit Teknik për shqyrtimin e projekteve të shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe Kryetar i Grupit të Oponencës. Pozicionimi i Drejtorit Ekzekutiv njëkohësisht në cilësinë e Kryetarit në dy organe vendimmarrëse (KT dhe OT) është i papajtueshëm me detyrat e tij funksionale në punën vendimmarrëse dhe përbën konflikt interesi, në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” (trajtuar më hollësisht në faqen 53-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të rishikohet neni 13/1 e Statut-Rregullore, neni 3/ 3 Rregullore “Për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN” si dhe neni 3 i Rregullore “Për funksionimin e Këshillit Teknik të AKBN-së”, në lidhje me pozicionimin e Drejtorit Ekzekutiv në cilësinë njëkohësisht të Kryetarit në këto dy organe vendimmarrëse, pasi përbën konflikt interesi.

Menjëherë

7. Në Statut rregulloren e AKBN-së, konstatohet se grupi për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion, nuk është sanksionuar si organ kolegjal, vendimmarrës i përhershëm ashtu sikurse janë sanksionuar të gjithë organet vendimmarrëse të AKBN-së të tilla si: Këshilli Drejtues, Këshilli Teknik. Ky organ është ngritur dhe funksionon mbi bazën e rregullore “Për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN”. Gjithashtu konstatohet se AKBN ka kontraktuar konsulentë të jashtëm në përputhje me neni 13/1 të statut rregullore, për raste të veçanta për të cilat kërkohet asistencë e specializuar. Në kontratë, pagesa e konsulentit nuk ka asnjë referencë ligjore, veprim i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2 (trajtuar më hollësisht në faqen 53-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të plotësohet statut rregullorja me funksionin dhe misionin e Grupit të Oponencave Teknike, i ngritur në zbatim të nenit 3 të VKM nr. 547, datë 9.8.2006 me ndryshime. Të saktësohet procedura me rastet e kontraktimit të konsulentëve të jashtëm, me qëllim që shpenzimi i kryer nga institucioni të jetë në përputhje me ekonomikitetin e fondeve në dispozicion.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nga auditimi mbi funksionimin dhe organizimin e Këshillit Drejtues të AKBN, konstatohet se me Vendimin nr. 7, datë 20.3.2014 të tij, janë miratuar ndryshimet në Buxhetin e AKBN-së për vitin 2014. Ndryshimet rezultojnë në shtim të fondit për zërin (31) shpenzime për “Kontroll mjekësor” për punonjësit e AKBN-së, në vlerën 2,700,000 lekë. Vendimi është miratuar me Urdhrin nr. 127, datë 20.3.2014 të Ministrisë të MEI-t. Shtimi i këtij zëri në buxhet është argumentuar duke u bazuar në ligjin Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, neni 23, pika 1. Argumentimi është i pa bazuar pasi ligji të cilit i është referuar KD për të argumentuar shtimin e këtij zëri buxhetor, që në titull e ka të përcaktuar objektin e veprimtarisë së tij, që është “**sigurimi i shëndetit në punë**” dhe jo “**kontroll mjekësor**”. Në kushte të tilla, nuk mund të justifikohet planifikimi në Buxhet i këtij shpenzimi, pasi bie në kundërshtim me

Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshime, neni 2, si dhe shpenzimi i kryer nga AKBN nuk është eficient, në një kohë që punonjësit janë të siguruar dhe përfitojnë nga Ligji nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu dhe në Programin Kombëtar të Qeverisë 2013, është parashikuar si objektiv kontrolli bazë shëndetësor për të gjithë shqiptarët rezidentë (check up-in) falas, pavarësisht nëse janë apo jo, të siguruar për kujdes shëndetësor.

Për pasojë, pika 31, shpenzime për “Kontroll mjekësor” për punonjësit e AKBN-së, miratuar me Vendimin nr. 7, datë 20.3.2014 të KD në vlerën 2,700,000 lekë, është e pa bazuar ligjërisht.

Gjithashtu dhe shpenzimi i kryer nga AKBN me Urdhër xhirimin datë 31.12.2014, për kontrollin mjekësor të punonjësve në vlerën **2,625,000 lekë** në favor të Klinikës Italiane “S.A”, është një shpenzim i pajustificuar ligjërisht dhe bie në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 2 duke përbërë dëm ekonomik për buxhetin.

Për vitin 2015, KD me Vendimin nr. 1, datë 16.2.2015 ka miratuar buxhetin e AKBN-së në të cilin përfshihet zëri (34) “kontroll mjekësor” për personelin e AKBN-së në vlerën 2,250,000. Përfshirja e këtij zëri në Buxhetin e AKBN është e pa bazuar ligjërisht referuar interpretimit të bërë më lartë në lidhje me këtë fakt si dhe është në kundërshtim dhe me VKM nr. 185, datë 2.4.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 40-65 vjeç”. Në zbatim të pikës 7 të këtij vendimi, është lidhur nga FSDKSH kontrata datë 8.01.2015 me koncensionarin “3P” sh.p.k. me objekt “Financimi nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, i shërbimeve të koncensionarit lidhur me ofrimin e paketës së kontrollit mjekësor bazë ndaj popullatës në përputhje me kontratën koncensionare nënshkruar mes palëve”. Për pasojë shpenzimi i kryer nga AKBN me Urdhër xhirimin datë 20.7.2016 në vlerën 1,899,072 lekë dhe Urdhër xhirimin datë 21.7.2016 në vlerën 133,056 lekë, gjithsej **2,032,128** lekë në favor të Klinikës Italiane “S.A”, përbën **dëm ekonomik** për buxhetin (*trajtuar më hollësisht në faqen 48-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Spektori i Financës të bëjë kontabilizimin dhe të sigurojë shpërblimin e dëmit në shumën totale 4,657,128 lekë nga punonjësit që kanë përfituar kontrollin mjekësor.

Menjëherë

2. Nga auditimi mbi funksionimin e Këshillit Teknik, konstatohet se me Urdhrin nr. 865, datë 28.10.2013 me ndryshime, të Ministrit, në përbërje të tij, janë emëruar dhe dy anëtarë të jashtëm N. K dhe R. T, njëri nga R.I.SH.M.I dhe një nga SH.GJ.SH. Emërimi i këtyre dy anëtarëve është bërë në kundërshtim me nenin 3 të Rregullores, ku në mënyrë eksplicite është sanksionuar se ” ... *Anëtarët e Këshillit Teknik janë punonjës të AKBN*”. Për pasojë ato janë paguar në kundërshtim me nenin 3 të Rregullores së funksionimit të Këshillit Teknik për 6 mujorin e II-të viti 2014, 2015 dhe 8 mujori 2016, gjithsej në vlerën 591,360 lekë.(sipas listës bashkangjitur), (*trajtuar më hollësisht në faqen 52-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Spektori i Financës të bëjë kontabilizimin dhe të sigurojë shpërblimin e dëmit në shumën totale **591,360** lekë nga anëtarët e Këshillit Teknik.

Menjëherë

3. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2015, janë shpërblyer 5 anëtarë (përfshirë 1 sekretar) të Grupit të Oponencës Teknike, në vlerën **459,000** lekë dhe për **3 mujorin 2016**, në vlerën **459,000** lekë, në kundërshtim me nenin 3, pika 5 të Rregullores, pasi janë punonjës të AKBN-së,

të cilat kanë detyrë funksionale sigurimin e oponentëve teknike, sipas Statut-Rregullores me ndryshime, neni 18, pika 3. *(trajtuar më hollësisht në faqen 53-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

Sektori i Financës të bëjë kontabilizimin dhe të sigurojë shpërblimin e dëmit në shumën totale **1,989,000 lekë** nga anëtarë e Grupit të Oponentëve Teknikë:

Menjëherë

D. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NE BUXHET

Pasqyrat financiare janë audituar nga një Auditues i Pavarur, i cili ka dhënë opinionin për pasqyra të hartuara mbi bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, duke marrë referencë në rregullat që mbulojnë raportimin financiar të shoqërive tregtare. Pasqyrat financiare reflektojnë një fitim kontabël prej 58,556,728 lekë, për vitin 2014 dhe një fitim në vlerën 40,664,795 lekë për vitin 2015. AKBN ka dorëzuar pasqyrat financiare pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë por nga auditimi nuk rezulton të jetë **llogaritur dhe derdhur tatimi mbi fitimin** në shumën prej 8,783,510 lekë, për vitin 2014, dhe në shumën prej 6,100,020 lekë, për vitin 2015, gjithsej **në shumën 14,883,530 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Audituesi i pavarur nuk është shprehur për faktin që AKBN, të paguajë ose jo tatimin mbi fitimin në masën 15% të fitimit të realizuar, megjithëse është shprehur që auditimi është bërë bazuar në kërkesat e Ligjit për shoqëritë tregtare. *(trajtuar më hollësisht në faqen 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN të realizojë derdhjen në buxhet të tatimit mbi fitimit e deklaruar në pasqyrat financiare në shumën **14,883,530 lekë**.

Menjëherë

II. MBI SHFRYTËZIMIN E BURIMEVE HIDROKARBURE

A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Në Licencë Marrëveshjet Hidrokarbure, përcaktohet se, AKH (sot AKBN), ka të drejtën të inspektojë dhe auditojë librat e llogarisë dhe dokumentacionin e kontabilitetit të të Licencuarit në lidhje me operacionet hidrokarbure, por jo më shpesh se një herë në një vit fiskal, përveçse kur bihet dakord ndryshe me operatorin. Kjo e drejtë auditimi përfundon tre vjet pas datës në të cilën i Licencuari dorëzon dokumentacionin e tij të kontabilitetit për atë vit fiskal, përndryshe, ky dokumentacion kontabiliteti gjykohet të jetë i saktë dhe më vonë nuk mund të jetë objekt kundërshtimi.

Në Licencë Marrëveshje janë përcaktuar si “Operacione Hidrokarbure” të gjitha operacionet që realizohen nga i Licencuari pas datës efektive, duke përfshirë pa u kufizuar në: testimin, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, trajtimin, transportimin dhe ruajtjen e hidrokarbureve, do të thotë se nga ana e AKH (Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve) kjo veprimtari auditimi duhej të kishte filluar për vitin 2005. Sipas praktikave ndërkombëtare të auditimit të marrëveshjeve hidrokarbure, objektivi kryesor i auditimeve nga përfaqësuesit shtetërorë (në këtë rast AKBN) është që të ofrojë siguri se kontraktori i ka kryer të gjitha operacionet hidrokarbure në përputhje me termat dhe kushtet e marrëveshjes, kjo duke synuar që të mbahet në kontroll faktori R i domosdoshëm për ndarje të fitimit në natyrë, ndërmjet shtetit dhe shoqërisë.

Konstatohet se AKBN, ka realizuar auditimin e operacioneve hidrokarbure në afatin ekstrem të të drejtës së saj (në vitin e tretë), duke lënë jashtë kontrollit faktorin R, i cili sa do që i është afuar 1, asnjëherë nuk e ka arritur këtë, dhe në gjykimin tonë për paaftësinë e shtetit dhe institucioneve të tij për të monitoruar kostot në operacionet hidrokarbure.

Kështu AKBN, ka audituar dokumentacionin e shoqërisë BPAL mbi operacionet hidrokarbure të vitit 2011, vetëm në vitin 2014. Ndërsa në vitin 2015 është audituar dokumentacioni i vitit 2012, ndërkohë që ishte në proces aktivitetit i vitit 2013.

Vonesa në realizimin e funksioneve të saj ka sjellë që për shkeljet teknike, financiare dhe administrative, me një kosto të parikuperueshme në rreth 250,000,000 USD, B të mos zbresë këto shpenzime nga Kosto Hidrokarbure, duke e lënë në nivelin nën 1 faktorin R, duke e apeluar çështjen në Arbitrazhin Ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, konstatojmë se përveç marrëveshjes për Vendburimin e Visokës, të gjitha marrëveshjet e tjera nuk janë audituar për aktivitetet e vitit 2014 dhe 2015. Mos auditimi i këtyre marrëveshjeve dhe lënia pa auditim për periudha të gjata kohore vështirësojnë jo vetëm auditimin por krijojnë hapësira për përfshirjen në operacione hidrokarbure, të kostove jo të lidhura me këto procese si dhe fryrjen në mënyrë abuzive të shpenzimeve pjesë të operacioneve hidrokarbure, praktika të konstatuara nga auditimi pjesor i marrëveshjeve hidrokarbure nga KLSH, në këto dy vitet e fundit.

Nga ana tjetër konstatojmë se mungon një kuadër i plotë për të përcaktuar vlerën reale apo për të mundësuar krahasimin e çmimeve të paguara me ato që mund të quhen vlera tregu, duke pamundësuar AKBN por edhe ne si auditues të përcaktojmë nivelin e shtuar të kostove të raportuara në këto operacione hidrokarbure. Mungesa e një baze rregullative apo një reference tregu me të cilin të orientohen çmimet e mallrave dhe shërbimeve, dhe monitorimi pas ndodhjes së shpenzimeve bën që në çdo rast që të vlerësohen kostot e shtuara gjykimi të jetë në nivel hipotetik. (trajtuar më hollësisht në faqen 86-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN në bashkëpunim me Albetrolin dhe MEI, të auditojnë Marrëveshjet Hidrokarbure brenda 6 muajve të parë nga dorëzimi i dokumentacionit të kontabilitetit për vitin fiskal, duke i dhënë prioritet auditimit të Marrëveshjes Hidrokarbure të lidhur me B. P, A. për vendburimin e naftës Patos-Marinës e cila zë rreth 95% te prodhimit ekzistues në rangë vendi, si dhe pa harruar auditimin e Marrëveshjeve të tjera Hidrokarbure.

Komisioni Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregëtinë dhe Mjedisin pasi të ketë dëgjuar përfaqësuesit e AKBN dhe Albetrolit, të vlerësojë dhe vendosi për të ndërhyrë në mënyrën e auditimit të marrëveshjeve hidrokarbure, në mënyrë që të realizohet një monitorim dhe kontroll i kujdesshëm, efektiv dhe në kohë reale të shpenzimeve të përfshira në Kostot Hidrokarbure. Gjykojmë të nevojshëm por dhe të domosdoshëm që auditimi dhe certifikimi i këtyre kostove të realizohet nga grupe auditimi me përbërje nga AKBN, Albetrol dhe inspektor të tatimeve.

Brënda vitit 2017

2. Në Marrëveshjen Hidrokarbure për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Vendburimin e Patos-Marinës cilësohet se “Kontraktori do të jetë përgjegjës për Taksën mbi Fitimin në përputhje me Ligjin nr.7811, datë 12.04.1994 “Mbi aprovimin e Dekretit nr.782, datë 22.2.1994 “Mbi sistemin fiskal në sektorin hidrokarbur (Kërkim-Prodhim)”, dhe i ndryshuar me Ligjin nr.8297, datë 04.03.1998, dhe në përputhje me License Marrëveshjen”, neni 13.1.

Në Licensë Marrëveshje “Fitimi” ka kuptimin e diferencës, që mund të krijohet në çdo Vit Fiskal midis (i) Hidrokarbureve të Disponueshëm mbas zbritjes së Pjesës së Albpetrolit, dhe (ii) Hidrokarbureve për Mbulim Kostoje e marrë nga i LICENSUAR1-i. Ndërkohë që çështja e tatim fitimit gjen shpjegim në nenin 10.2 (b) “Tatimi mbi fitimin e hidrokarbureve”, duke përcaktuar referencën në Ligjin nr.7811, datë 12.04.1994 “Mbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve, siç është amenduar nga Ligji nr.8345 i datës 13.05.1998 dhe sic mund te amendohet kohë pas kohe.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit “Mbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve” “Kontraktuesi detyrohet të paguajë, në çdo vit fiskal, tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal, si dhe taksën e rentës minerare për hidrokarburet që nxjerr nga nëntoka. Tatimi mbi fitimin tërhiqet në para, siç parashikohet në çdo marrëveshje hidrokarburesh. Taksa për rentën minerare paguhet në sasinë dhe sipas procedurave, që përcaktohen në Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.Tatimi mbi fitimin është në masën 50 për qind të fitimit të realizuar.

Ajo që konstatohet është se në këtë ligj nuk gjejmë referencë për mbulimin e humbjeve të mbartuara fiskale, ndërkohë që mungon ose më saktë nuk shprehet nëse gjejmë zbatim kërkesat e Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, sic është shprehur për referencën ligjore të taksës kombëtare (për rentën minerale).

Në kushtet kur tashmë ka filluar paraqitja e bilanceve pozitive nga ana e të LICENSUARIT, kështu **për vitin 2014 ka pasur rezultat pozitiv në shumën 45,572,000 USD, ndërkohë që rezultati pozitiv për vitin 2013 ishte në shumën 57,000,000 USD, dhe shteti nuk ka përfituar asnjë lekë si tatim fitimi**, shtrohet si domosdoshmëri trajtimi dhe sqarimi i kësaj problematike nga institucionet përgjegjëse, në mënyrë që të shmanget cdo paqartësi në lidhje me detyrimin tatimor.

Theksojmë faktin se nëse do të konsiderohet i aplikueshëm Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, në referencë të përcaktimeve të nenit 27 (2) “Mbartja e humbjeve”, kur pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose e tërthortë e kapitalit themeltar ose e të drejtave të votës, të një personi, ndryshon me më shumë se 50 për qind, ne vlerë ose në numër, nuk mbarten humbjet e pësuar nga ai person juridik në atë periudhë tatimore dhe në periudhat paraardhëse të tatimit (trajtuar më hollësisht në faqen 79-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Komisioni i Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, të vlerësojnë nevojën për plotësim apo amendim të Ligjit “Mbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve”, me aspektet e munguara, kryesisht saktësimin e faktit që kostot hidrokarbure mbarten për efekte të ndarjes së prodhimit, ndërsa fitimi fiskal është rezultati financiar pozitiv në një vit fiskal. Për shkak të ndjeshmërisë së kësaj problematike, aspekteve përtej teknikës fiskale, kërkojmë që zgjidhja e kësaj problematike, të kalojë në një vendimarrje përtej ekzekutivit.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

I. Marrëveshja Hidrokarbure me Kompaninë “B.P.A” zë rreth 95% të prodhimit të naftës ekzistuese në vend dhe shtrihet në zonën e vendburimit e naftës mbajtës Patos-Marinëz. Marrëveshje është lidhur në 20.07.2004, pra aktualisht ajo ndodhet në vitin e 12, ndërkohë shteti shqiptar nuk ka arritur të përfitojë përtej rentës minerare nga shfrytëzimi i këtij vendburimi, kjo

¹ I LICENSUAR- këtu e në vijim shoqëria B. P. A

për shkak të paaftësisë së institucioneve të ngritura për monitorimin dhe kontrollin e shfrytëzimit të burimeve hidrokarbure. Nga auditimi i realizuar mbi një dokumentacion jo të plotë të disponueshëm pranë AKBN, rezultoi:

1. Programet Vjetore në funksion të planeve të zhvillimit

Në referencë të kërkesave të nenin 7.2 të Licencë Marrëveshjes për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Vendburimin e Patos-Marinëz. AKH (sot AKBN), është përgjegjëse për miratimin e Planeve Vjetore dhe Buxheteve për çdo vit fiskal, duke kërkuar jo vetëm përputhshmëri me Planin e Zhvillimit por edhe një pamje e plotë e operacioneve që do të përmbushen gjatë vitit në plotësim të objektivave. Bazuar në nenet 8.3 të MH dhe 7.2 (c) të LMH, përcaktohet se *“nëse AKBN nuk e njofton të Licensuarin për ndonjë ndryshim brenda 30 ditëve, propozimi i paraqitur (plani vjetor dhe buxheti përkatës) do të konsiderohen të mirëqena... Ajo që është konstatuar nga auditimi është që asnjë nga Planin Vjetore dhe Buxhetet e periudhës objekt auditimi, nuk është miratuar sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në bazën rregullative.*

Kështu I LICENSUARI për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Vendburimin e Patos-Marinëz i është drejtuar Albpetrolit, në datë 10.02.2014 (në kundërshtim me afatet e përcaktuara), duke kërkuar aprovimin e planit të punës dhe buxhetit për vitin 2014, të aprovuar në mbledhjen e KK të datë 06.12.2013 me anë të Vendimit nr.1, në të cilin mungojnë firmat e tre përfaqësuesve të Albpetrolit. Për shkak të mungesës së dakordësimit me Albpetrolin dhe dërgimin e planeve në mënyrë jo të rregullt, miratimi i Planit të Punës dhe Buxhetit për vitin 2014, nga AKBN, mban datën 12.02.2015.

Drafti i Planit të Punës dhe Buxhetit të vitit 2015, është dërguar në AKBN në datë 31.10.2014. AKBN, në datë 06.03.2015 i ka kërkuar Albpetrolit, vlerësimin në lidhje me Planin e Punës dhe Buxhetin për vitin 2015. Në datën 29.09.2015, I LICENSUARI, ka ridërguar Planin e Punës dhe Buxhetin për vitin 2015 për miratim, duke theksuar se *“...pavarësisht vonesës së miratimit të Planit të punës dhe Buxhetit të vitit 2015, shoqëria ka vazhduar operacionet hidrokarbure në përputhshmëri me atë të diskutuar në KK”*, ndërkohë që konstatohet se kjo vendimarrje nuk është firmosur nga anëtarët përfaqësues të Albpetrolit në KK. Miratimi nga AKBN i Planit të Punës dhe Buxhetit për vitin 2015, mban datën 26.05.2016.

Në datën 02.10.2015 I LICENSUARI ka dërguar tek Albpetroli dhe AKBN, Planin e Punës dhe Buxhetit për vitin 2016, të pa dakordësuar me Albpetrolin. Në datën 07.01.2016, AKBN i është drejtuar Albpetrolit dhe të LICENSUARIT në lidhje me ndryshimet në Planin e Punës dhe Buxhetit të vitit 2016, për tu dakordësuar lidhur me pretendimet e ngritura nga Albpetrol lidhur me mos konsistentencën e këtij plani me Planin e Zhvillimit të vitit 2009, pasi kanë konstatuar se nuk janë parashikuar aktivitete për riaktivizimin e puseve; mungojnë aktivitetet për zhvillimin e komunitetit sipas nenit 27 të MH; kostot operacionale në lidhje me pagesat e punonjësve të huaj janë rritur; nuk janë parashikuar aktivitete për rehabilitimin mjedisor; si dhe theksohet fakti që në angazhimet e kontraktorit faktori $R > 1$ do të ishte brenda vitit 2015, ndërkohë që në Planin e paraqitur të vitit 2016 ky faktor mbetet akoma më < 1 . Deri në periudhën e këtij auditimi ky draft PP&B nuk është miratuar nga Albpetrol dhe AKBN.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se procedura e miratimit të Planeve Vjetore dhe Buxheteve:

-Nuk realizohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Marrëveshjes Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjes

-I LICENSUARI, paraqet plane të pa dakordësuar nga përfaqësuesit e Albpetrolit në KK, ndërkohë që nuk shfrytëzon kërkesat e Licencë Marrëveshjes për trajtimin e mosdakordësisë

përmes një eksperti. Programet Vjetore të periudhës objekt auditimi janë paraqitur me mungesë të firmave të përfaqësuesve të Albpetrolit në KK

-Korespondenca janë formale me mungesë argumentesh

-Miratimi në heshtje dhe në tejkalim të afateve të kërkuara

Për sa konstatuam mund të konkludojmë që procesi i miratimit të këtyre Planeve është një proces formal.

Në gjykimin tonë procesi i shqyrtimit dhe miratimit të Planeve të Punës dhe Buxheteve është një funksion kryesor i AKBN, dhe mos realizimi sic duhet i të cilit ka impakt jo vetëm në ecurinë e marrëveshjeve por impakton edhe faktorin R dhe fitimin fiskal të shoqërive të licensuara për të realizuar zhvillimin dhe prodhimin e vendburimeve hidrokarbure.

Për sa më sipër rekomandojmë

Nga ana e AKBN, të mos tolerohen praktikat e miratimit në heshtje dhe formal të Planeve Vjetor dhe buxheteve të paraqitura. Të kërkohej plotësi e informacionit të paraqitur lidhur me vendimmarrjet në KK, ku të shprehet në çdo rast mendimi kundër dhe shpjegohet mungesa e firmës së përfaqësuesve të Albpetrolit.

Të ndiqen me rigozitet kërkesat e përcaktuara në Marrëveshjet hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshje për shqyrtimin dhe dakordësimin e planeve si të zhvillimit dhe atyre vjetore në zbatim të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Shpenzimet e deklaruara në Kosto Hidrokarbure dhe dokumentimi i tyre

2.1. Në bazë të Kuadrit rregullator në fuqi, AKBN ka përgjegjësinë për të verifikuar rregullshmërinë e shpenzimeve të realizuara në Licencë Marrëveshjet e rena dakord. Në zbatim të kërkesave të nenit 15.2 të Licencë Marrëveshjes, “*jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të çdo periudhe gjashtëmujore i LICENSUARI i dorëzon AKH (sot AKBN) kopje të dokumentacionit të llogarive që pasqyrojnë Kostot Hidrokarbure që ai realizon gjatë asaj periudhe. Dokumentacioni llogaritës do të jetë me hollësi të mjaftueshme për të lejuar AKH të përcaktojë rregullsinë e Kostove Hidrokarbure të realizuara. Në shtesë të sa më sipër ai do ti japë AKH kopje të regjistrave të Operacioneve Hidrokarbure, ashtu siç janë kryer*”.

Konstatohet se nga ana e të LICENSUARIT, nuk është përmbushur plotësisht ky detyrim pasi konstatohet se nuk janë dërguar në AKBN kopje të dokumentacionit kontabël që pasqyrojnë me hollësi shpenzimet e kryera si dhe raporte mbi punët e nën kontraktorëve e përfshirë në këto operacione hidrokarbure. Nga ana tjetër edhe AKBN nuk ka kërkuar zyrtarisht që të dërgohen këto dokumentacione për të konfirmuar dhe miratuar rregullshmërinë e kostove hidrokarbure të kryera, ashtu siç përcaktohet në licencë marrëveshje. Procedura është minimizuar me Raporte të dhënash sintetike dhe vetëm të bilanceve vërtetues në fund të periudhave tre-mujore.

Ajo që konstatuam nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në AKBN, është një fryrje në mënyrë të pajustificuar të shpenzimeve, ndërkohë që për shpenzimet në nivele mbi 2 milionë USD nuk ka procedurë tenderuese dhe aq më pak mbikqyrje nga ana e Albpetrolit të mënyrës se si prokurohen shërbimet/mallrat e përfshira në Operacione Hidrokarbure, veprime që bien në kundërshtim me nenin 21 të Marrëveshjes Hidrokarbure, ku përcaktohet se: “Kontraktori, kontraktoret dhe nën-kontraktoret e tij do të japin prioritet mallrave dhe materialeve të prodhuara në Shqipëri nëse këto mallra dhe materiale ofrohen sipas kushteve favorizuese të barabarta në lidhje me cilësinë, çmimin dhe disponueshmërinë, dhe në sasi të kërkuara. Për qëllimet e mësipërme, çmimet për materialet, pajisjet, makineritë dhe gjërat e konsumueshme të prodhuara brenda vendit dhe për shërbimet e kontraktorëve lokal duhet të jenë të krahasueshëm

me çmimet e mallrave dhe shërbimeve në tregun ndërkombëtar pasi të jenë shtuar kostot për transport dhe siguracion.”, ndërkohë që kërkohet që nga Kontraktori të bëhen tendera konkurrues për ndonjë shërbim të kryer në përputhje me çështjet e përfshira në Programin Vjetor dhe Buxhet, në se shërbimet priten të kalojnë dy milionë USD, dhe lejohet Albetroli të mbikëqyrë procedurat”.

Auditimi i AKBN për certifikimin e Kostove Hidrokarbure, është i vonuar në kohë (me rreth 3 vite pas mbylljes së viteve fiskale), kohë në limitet fundore të përcaktuara në Licencë Marrëveshje ka krijuar hapësira për praktika abuzive me efekte të shtuara në Koston Hidrokarbure, shoqëruar me ndikim negativ në arritjen e faktorit “R”. Të dhënat në AKBN tregojnë se deri në fund të muajit Qershor 2016, janë shpenzuar gjithsej rreth 2,744 milion USD, nga të cilat rreth 1,454 milion USD janë investime kapitale (CAPEX) dhe 1,290 milion USD janë shpenzime operative (OPEX). Pra për periudhën janar- qershor 2016 shpenzimet e bëra për operacione hidrokarbure nuk mbulohen nga të ardhurat e përfituara nga shitja e naftës dhe humbja e akumuluar është rritur për 215 milion USD. Faktori R në fund të kësaj periudhe del në koeficientin 0.921. Ky koeficient është përkeqësuar referuar të dhënave të vitit 2015 dhe atij të vitit 2014. Kështu kemi rënien krahasuar me koeficientin 0.945 të arritur në vitin 2014 dhe koeficientit 0.924 të rezultatit të vitit 2015.

Disa nga faktet mbi të cilat gjykojm se kostot e deklaruar janë të fryra dhe në to ka edhe praktika abuzive me ndikim në Kostot Hidrokarbure, përmendim:

- Kemi konstatuar se për shërbime, punime të ndërtimit, shoqëritë “A”, “” dhe “B”, së bashku kanë përfituar pagesa përafërsisht 20-22 milion USD për vitin 2015 dhe për 6 muajt e vitit 2016 kanë përfituar përafërsisht 10-12 milion USD. Mbi bazë të të dhënave të tregut këto shpenzime janë rreth 50% me çmime më të larta. Në rritjen e këtyre kostove, faktor shtesë është mungesa e procedurave tenderuese në realizimin e tyre, veprim në kundërshtim me përcaktimet në Licencë Marrëveshje (trajtuar më hollësisht në faqen 6-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga BPA, është lidhur kontratë për marrje me qira të 32 apartamenteve banimi për personelin e saj nga një person fizik, në lagjen “1 Maj”, Fier. Këto apartamente janë me sipërfaqe totale 4.050 m², dhe vlera totale mujore e qirasë është përcaktuar 22,500 Euro ose vlera e një apartamente të marrë me qira është rreth 700 Euro në muaj, çmim që në referencë të tregut në Tiranë është shumë i lartë jo më pastaj po ti referohemi çmimeve të tregut të qirave në Fier (trajtuar më hollësisht në faqen 72-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Për periudhën e auditimit, konstatohet se janë lidhur kontrata me shoqëritë “B-O”, “A D”, “B T” dhe “O”, për kryerjen e disa procedurave të ndryshme hidrokarbure ndër to edhe për shërbimin e transportit. Me gjithë dokumentacionin e paket në AKBN evidentuam se çmimet e transportit të naftës bruto, por edhe të shërbimeve të ndryshme janë më të larta se vlerat në referencë të tregut vendas. Sipas kontratës së kompanisë “B-O”, e cila zë vlerën më të madhe të shërbimit të transportit, çmimi i transportit të naftë bruto nga Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN), Fier në TEC-n e Vlorës (Petrolifera) është 970 lekë për m³, ose 31.6 lekë ton/km. Ndërsa çmimi i shërbimit të transporti të naftës bruto nga vetë Albetroli me shoqëritë e kontraktuar prej saj nëpërmjet procedurave tenderuese, për kryerjen e këtij shërbimi, është 18 lekë për ton /km. Pra, konstatohet një cmim afërsisht 43% më i lartë për se çmimi i kontraktuar nga Albetroli. Kjo rritje ka ndikuar në Kostot Hidrokarbure për sa kohë që shpenzimet e transportit janë në nivelet 27,698,000 USD për vitin 2014, 19,696,000 USD për vitin 2015 dhe në periudhën janar-qershor 2016, kanë në nivelin 6,292,00 USD (trajtuar më hollësisht në faqen 73-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Sipas analizimit të disa dokumenteve të marra nga Albetroli, rezultoi se, në fund të vitit 2015, BPA ka të lidhura rreth 750 kontrata për marrje tokë me qira, me sipërfaqe të përgjithshme afërsisht rreth 2,260,000 m², për sipërfaqe toke të marrë më qira para vitit 2015 dhe për kontatat

të lidhura gjatë këtij viti, dhe për këtë sipërfaqe toke ka paguar qira afërsisht rreth 914,500,000 lekë. Bazuar në të dhëna të përafërta, çmimi mesatar i takave bujqësore të marra me qira nga BPA për periudhën 2006-2015 është rreth 300-400 lekë m² në vit. Evidentuar se ky çmim është më i lartë se çmimet e qirasë së tregut të zonës Potos-Marinzë. Kështu, nga auditimi është konstatuar se në datën 01.10.2012, është lidhur kontratë për marrje me qira të 11,186 m² nga z.A. K, me çmim qiraje 155 lekë për m² në vit, me vlerë totale 1,733,830 lekë. Kjo sipërfaqe toke bujqësore nga z.A. K është marrë me qira nga Komuna “Kuman” Fier, në datën 03.10.2012, për 7 lekë për m² në vit. Nga kjo kontratë Komuna nuk ka përfituar diferencën e çmimit, e cila për periudhën e auditimit rezulton në **6,622,112 lekë.**

- Në datën 01.09.2012, është lidhur kontratë për marrje me qira të 6.133 m² tokë bujqësore nga znj.M. Gj. Çmimi i qirasë është përcaktuar 400 lekë për m² në vit me vlerë totale 2,453,200 lekë. Qiradhënësja, për të vërtetuar pronësinë e tokës, në mungesë të certifikatës së pronësisë ka bashkëlidhur kontratën e blerjes së kësaj toke nga të tretët, me çmim 489 lekë për m². Pra, çmimi i qirasë është pothuajse i barabartë me çmimin e shitjes së tokës bujqësore në atë zonë. Dhe vetëm vlera vjetore e qirasë së vitit të parë pothuajse mbulon çmimin e blerjes së tokës. Rritja e vlerës së qirasë mbi çmimet e tregut ka ndikuar ndjeshëm në uljen e faktorit R dhe në fitimin e kompanisë *(trajtuar më hollësisht në faqen 74-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Në përfundim arritëm se monitorimi nga AKBN ka qënë formal mbi bazë të tabelave dhe jo analizave të detajuara të transaksioneve të ndodhura, kjo ka sjell edhe ndikimin në faktorin “R”. Të gjitha konstatimet e auditimeve të KLSH dhe jo vetëm, ndonëse janë të paplota për mungesë të theksuar të dokumentacionit në AKBN tregojnë për shkallën me të cilën janë fryrë për vite me radhë shpenzimet si Operacione Hidrokarbure si dhe faktojnë arësyen kryesore se përse pas kaq vitesh faktori “R” vazhdon të paraqitet në vlera nën 1.

Nga ana tjetër konstatojmë se mungon një kuadër i plotë për të përcaktuar vlerën reale apo për të mundësuar krahasimin e çmimeve të paguara me ato që mund të quhen vlera tregu, duke pamundësuar AKBN por edhe ne si auditues të përcaktojmë nivelin e shtuar të kostove të raportuara në këto operacione hidrokarbure. Mungesa e një baze rregullative apo një reference tregu me të cilin të orientohen çmimet e mallrave dhe shërbimeve, dhe monitorimi pas ndodhjes së shpenzimeve bën që në çdo rast që të vlerësohen kostot e shtuara gjykimi të jetë në nivel hipotetik.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Duke e konsideruar parësor kontrollin e rregullshmërisë së shpenzimeve në sektorin hidrokarbur në përmbushje të misionit monitorues, i kërkojmë AKBN, të realizojë auditimin e kësaj marrëveshje për aktivitetin e viteve 2014 dhe 2015 brënda një periudhe 3-6-mujore.

Brenda datës 31.07.2017

Të kërkohej që brenda muajit mars, BPA (shoqëria) të paraqesë pranë AKBN, të gjitha regjistrimet kontabël dhe dokumentacionin shoqëruar fotokopje për tre vitet e fundit (2014, 2015, 2016), vite për të cilat nuk është realizuar akoma auditimi nga sektori përkatës në AKBN.

Menjëherë

AKBN në bashkëpunim me MEI, të hartojë një rregullore të plotë për mënyrën se si duhet të paraqitet informacioni lidhur me Kostot Hidrokarbure, ku të përcaktohen qartë të dhënat e kërkuara, dokumentacioni kontabël, llogaritë dhe Raportet Përmbledhëse mbi Kostot, shoqëruar me afate të qarta kohore, të paraqitjes së tyre. Të përcaktohet një metodologji referuese, për të vendosur mbi rregullshmërinë dhe nivelin e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, akte ligjore dhe nënligjore, statistika zyrtare referuese për të vlerësuar deviacionet nga vlerat normale të tregut sipas kategorizimeve të shpenzimeve të këtij sektori specifik.

2.2 Nga auditimi është konstatuar se në vitin 2014, shoqëria ka kryer shpenzime (kosto hidrokarbure) në vlerën totale 497,572,000 USD, në vitin 2015, ka kryer shpenzime (kosto hidrokarbure) në vlerën 344,115,000 USD dhe deri në fund të qershorit 2016, shpenzimet (kosto hidrokarbure) kanë arritur në vlerën 80,380,000 USD. Kosto Hidrokarbure e akumuluar ka arritur në vlerën 2,749,659,000 USD. Kemi konstatuar përqëndrim të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në një numër të kufizuar operatorësh ekonomik. Kontraktorët kryesorë vendas janë “B-O” me një faturim vjetor me rreth 10 milion USD; “A”, me faturim afërsisht 25 milion USD; T.C faturim me rreth 3.5 milion USD; “Q- S”, faturim me rreth 5.5 milion USD. Ndër kontraktorët e huaj përmendim “S”, me faturim vjetor 35 milion USD; “P-T”, me faturim vjetor 20 milion USD; “C” me faturim vjetor 20 milion USD; “E A” ka faturim vjetor 3 milion USD; “A-H” kompani e huaj, me faturim vjetor 9 milion USD; “S S”, kompani e huaj me faturim vjetor 3 milion USD; etj. Të gjitha kontraktimet e mësipërme BPA, i ka realizuar në mungesë të plotë të procedurave tenderuese, në mungesë të konkurrencës dhe në anormalitet të çmimeve të sigurimit të shërbimeve dhe mallrave. *Mos organizimi i procedurave konkurruese është në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure e cila e detyron BPA që, për kontratat që janë mbi vlerën vjetore 2,000,000 USD duhet të organizoj tenderë konkurrues në të cilat mund të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Albpetroli.*

Konstatohet se për të siguruar mallrat/shërbimet e lidhura me proceset teknologjike të nxjerrjes së naftës, shoqëria ka lidhur kontrata kryesisht me kompanitë e huaja të regjistruara jashtë vendit me statusin e kompanive offshore. Regjistrimi i këtyre kompanive në këtë status, bën të pamundur identifikimin pronarëve (aksionerëve) dhe për pasojë bën të pamundur identifikimin e transaksioneve midis palëve të lidhura që mund të ekzistojë apo jo ndërmjet BPA dhe nënkontraktorëve të saj, kjo vështirësuar edhe nga fakti që sipas Licencë Marrëveshjes, lejohet mbajtja e llogarive jashtë territorit të Shqipërisë dhe realizimi i transaksioneve financiare përmes këtyre llogarive mbi të cilat auditimi është pothuaj i pamundur nga ana e AKBN.

Kemi konstatuar raste të sigurimit të shërbimeve dhe mallrave nga personat fizik dhe juridik vendas me të njëjtë aksionar (sipas të dhënave të QKR) duke hapur 3-4 kompani me emra tregtare të ndryshëm. Ky monopolizim, ka bërë që çmimet e mallrave, shërbimeve dhe punëve për kryerjen e operacioneve hidrokarbure të mbahen në nivele më të larta se çmimet e tregut vendas, sepse për vite më radhë proceset hidrokarbure me këto çmime janë dominuar dhe kontrollohen po nga këta sipërmarrës. Kështu kemi konstatuar se me kompaninë “A” është lidhur kontratë në datën 27.09.2004. Objekti i kësaj kontrate është kryerja e shërbimeve të ndryshme, punimeve civile dhe furnizim mallra. Kjo kompani, kryerjen e disa proceseve hidrokarbure ia ka deleguar disa kompanive të tjera vendase, pasi kompania nuk ka licencën për ushtrimin e disa prej veprimtarive, si p.sh nuk ushtron aktivitet ne proceset e kërkimit për hidrokarbure, për projektim, etj. Aksionarët e kësaj kompanie Sadik Ismailaj dhe Idajet Ismailaj të cilët kanë hapur edhe kompani të tjera për tu përfshirë në proceset hidrokarbure. Konstatohet se BPA ka lidhur disa kontrata me shoqërinë “V”, për shërbime, punime dhe furnizim mallrash, të cilat nuk na u vunë në dispozicion, ndërkohë që sipas ekstraktit të QKR, aksionerët e kësaj kompanie janë përsëri ortakët S. I dhe I. I. Që nga viti 2013, BPA ka lidhur kontrata me shoqërinë “A”, për kryerjen e punimeve civile, shërbimeve mekanike dhe furnizim mallrash. Sipas ekstraktit të QKR, aksionere e kësaj kompanie është kompania “A”, pra S. I dhe I. I.

Për periudhën e auditimit rezultoi se, shoqëritë “A”, “A” dhe “V”, së bashku kanë përfituar pagesa nga BPA, përafërsisht 20-22 milion USD për vitin 2015 dhe për 6 muajt e vitit 2016 kanë përfituar përafërsisht 10-12 milion USD. (trajtuar më hollësisht në faqen 6-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN ta shikojë procesin e auditimit jo si një proces formal vlerësimi të rregullshmërisë financiare të operacioneve hidrokarbure, por të auditoje dhe vlerësojë risqet e mashtrimit apo manipulimit me transaksionet financiare. AKBN të referojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të gjitha rastet e dyshuara si transaksioneve ndërmjet palëve të lidhur me qëllim që identifikohet jo vetëm impakti i këtyre marrëdhënieve në kostot hidrokarbure, por edhe shmangiet tatimore që sigurohen përmes transaksioneve në palë të lidhura.

Menjëherë

Për transaksionet ndërmjet shoqërive të huaja të realizuara jashtë territorit të Shqipërisë, të kërkohet që Ekspertët e Pavarur, që certifikojnë Pasqyrat Financiare vjetore, të japin një opinion të veçantë nëse kemi të bëjmë me transaksione ndërmjet palëve të lidhura.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PER ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË FAKTORIN “R”

Marrëveshjet Hidrokarbure janë marrëveshje me ndarje prodhimi (Production Sharing Agreements) sipas të cilës kompania ka detyrime që ti japi Albpetroli sh.a, për çdo vit dhe pjesën e naftës fitim që del nga llogaritja e Faktorit R.

Deri në qershor 2016, konstatohet se shoqëria ka shpuar gjithsej 622 puseve, ka shpenzuar gjithsej rreth 2,744 milion USD, prodhimin i naftës e ka rritur nga 264 mijë ton në vitin 2004 në 1,140 mijë ton në vitin 2015 si dhe ka përfituar të ardhura nga shitja e kësaj nafte rreth 3 miliard USD. Nga sasia e naftës së prodhuar dhe shitur, Albpetroli ka përfituar për gjithë periudhën e zbatimit të marrëveshjes rreth 200 milion USD, ndërsa buxheti i shteti ka përfituar vetëm nga renta minerare rreth 264 milion USD dhe nga tatimi mbi fitimin nuk ka përfituar asnjë të ardhur. Megjithëse prodhimi i naftës dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj sasive janë rritur ndjeshëm, Faktori R, si treguesi kryesor i balancës së treguesve të ardhura-shpenzime për gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes ka qenë në nivele të ulta pa arritur vlerën 1 dhe aktualisht, në fund të qershorit 2016, është 0.921. Mos arritja e faktorit R mbi nivelin 1 ka ndikuar drejtpërdrejt, në sasinë e pjesës së naftës që i takon Albpetroli dhe në nivelin e naftës fitim. Po kështu sipas draft planit të ri të zhvillimit të paraqitur nga kompania në mars 2016, i cili është ende në fazën e vlerësimit dhe të miratimit, arritja e faktorit R = 1 do të varet shumë nga situata ndërkombëtare e kuotimit të naftës bruto. Nëse çmimi i naftës është i lartë, faktori R = 1 mund të arrihet në vitin 2018, nëse çmimi është i mesëm, ky faktor mund të arrihet në vitin 2020, ndërsa nëse çmimi është i ulët, mund të arrihet mbas vitit 2024.

Ky vendburim naftë ka qenë ekzistues para lidhjes së marrëveshjes, çka do të thotë që shoqëria, nuk ka rënduar kostot hidrokarbure me shpenzime kërkimi, por ka filluar direkt prodhimin e naftës dhe për këtë arsye pritshmëria në lidhje me fitimin që do të vinte nga shfrytëzimi i kësaj pasurie kombëtare në dobi të popullit shqiptar ka qenë shumë e madhe. Mirëpo, ka ndodhur krejt e kundërta, ashtu siç u tha më sipër, BPA ka akumuluar një humbje prej 215 milion USD, dhe kjo humbje është shkaktuar sepse, AKBN (por edhe Albpetroli dhe MEI), në kundërshtim me licencë marrëveshjen kanë lejuar që BPA të kryej shpenzime për proceset hidrokarbure, mbi çmimet e tregut, për pasojë të ardhurat e realizuara nga shitja e naftës së prodhuar nuk kanë mbuluar kostot hidrokarbure, edhe pse në këto kosto nuk janë përfshirë shpenzimet e kërkim-zbulimit. Për këtë arsye, kompania shtetërore Albpetroli, nuk ka marrë sasinë e hidrokarburit të premtuar në planin e zhvillimit, si dhe buxheti i shteti nuk ka marrë naftën fitim. Këto veprime përveç sa bien në kundërshtim me licencë marrëveshjen, nuk përmbushin edhe qëllimin e ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për Hidrokarburet (kërkim dhe prodhim)”, i cili përcakton se: “Të

gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria përkatëse dhe të gjitha këto burime do të përdoren për dobinë e popullit shqiptar”.

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit, auditimi u krye në bazë të evidencave dhe situacioneve periodike të kostove hidrokarbureve që BPA i ka dërguar në AKBN në çdo tre mujor për llogaritjen e faktorit R, dhe në përfundim u konstatua:

1. Në vitin 2008, është lidhur kontratë për kryerjen e disa shërbimeve, kryesisht për shërbimin e transportit të naftës bruto, me kompaninë vendase “B-O”. Kjo kontratë është amenduar duke u shtyre në vazhdim dhe është në fuqi edhe për vitin 2016. Sipas ekstraktit të QKR aksionar e kësaj kompanie është z. B. Ç. Janë lidhur kontrata edhe me shoqëritë “A. D”, “B T” dhe “O”, për kryerjen e disa procedurave të ndryshme hidrokarbure ndër to edhe për shërbimin e transportit dhe sipas ekstraktit të QKR, aksionar i këtyre kompanive është z.B. Ç. Sipas këtyre kontratave, evidentuam se, çmimet e transportit të naftës bruto, por edhe të shërbimeve të ndryshme janë më të larta se, çmimet e tregut vendas. Për ta konkretizuar sjellim vetëm një fakt, çmimi i transportit të naftë bruto nga Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN), Fier në TEC-n e Vlorës (Petrolifera) është 970 lekë për m³, ose 31.6 lekë ton/km. Ndërsa çmimi i shërbimit të transporti të naftës bruto sipas kontratës së lidhur nga vetë Albetroli me shoqëritë e kontraktuar prej saj nëpërmjet procedurave tenderuese, për kryerjen e këtij shërbimi, është 18 lekë për ton /km. Pra, çmimi i kontraktuar nga BPA është 13.7 lekë për ton/km ose afërsisht 43% më i lartë për se çmimi i kontraktuar nga Albetroli. (trajtuar më hollësisht në faqen 73-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Në datën 07.06.2011, është rilidhur kontratë me shoqërinë “V”, me objekt “Rikonstruksioni i zyrave të BPA me sipërfaqe 2.000 m²”. Kjo kontratë është me vlerë investim 1,270,410 EURO ose 1,747,384 USD. Sipas ekstraktit të QKR shoqëria “V” nuk ushtron veprimtari në fushën e ndërtimit që i përket kategorisë së punimeve për rikonstruksion ndërtesash. Ndërtesa që do të rikonstruktohej është në pronësi të z. J. I i cili është djali dhe vëllai i aksionarëve I të shoqërisë “V” e cila ka marrë kontratën për rikonstruksionin e ndërtesës. Pas rikonstruksionit, në datën 05.07.2011, BPA ka lidhur një kontratë me pronarin e kësaj ndërtesë me z. J. I për marrje me qira të saj me vlerë 20,000 Euro në muaj, me afat 10 vjet me të drejtë rinovimi. Lidhja e kontratës së rikonstruksionit është në kundërshtim të hapur me nenin 11 të Marrëveshjes Hidrokarbure dhe me nenin 17 të Licencë Marrëveshjes të cilat përcaktojnë se “në përfundim të marrëveshjes të gjitha investimet që janë bërë nga BPA në proceset hidrokarbure, mbeten pronë e shtetit shqiptar”. Duke ju referuar referencave të tregut, kosto e rikonstruksionit të kësaj ndërtesë e tejkalon koston e ndërtimit, madje tejkalon çmimin e shitjes së banesave të asaj zone.

3. Në datën 19.05.2015, BPA ka lidhur kontratë për marrje me qira të 32 apartamenteve banimi për personelin e saj nga subjekti fizik M. M, në lagjen “1 Maj”, Fier. Këto apartamente janë me sipërfaqe totale 4.050 m², dhe vlera totale mujore e qirasë është përcaktuar 22,500 Euro ose vlera e një apartamente të marrë me qira është rreth 700 Euro në muaj. Afati kontratës është një vit duke filluar nga 01.04.2015 deri në 31.03.2016. Edhe në këtë kontratë, çmimi i qirasë së shtëpive është më i lartë se, çmimi i tregut të qirasë së shtëpive në këtë zonë të qytetit të Fierit dhe më i lartë se, çmimet e përcaktuara në VKM nr.469, datë 3.6.2015 (trajtuar më hollësisht në faqen 72-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Sipas analizimit të disa dokumenteve të marra nga Albetroli, rezultoi se, në fund të vitit 2015, BPA ka të lidhura rreth 750 kontrata për marrje tokë me qira, me sipërfaqe të përgjithshme afërsisht rreth 2,260,000 m², për sipërfaqe toke të marrë më qira para vitit 2015 dhe për kontratat të lidhura gjatë këtij viti, dhe për këtë sipërfaqe toke ka paguar qira afërsisht rreth 914,500,000 lekë. Bazuar në të dhëna të përafërta, çmimi mesatar i takave bujqësore të marra me qira nga

BPA për periudhën 2006-2015 është rreth 300-400 lekë m² në vit. Evidentuar se ky çmim është më i lartë se çmimet e qirasë së tregut të zonës Potos-Marinzë.

Për të mbështetur këtë konstatim po përmendim vetëm dy fakte të cilat shërbejnë për përgjithësimin e kësaj shkeljeje: Në datën 01.10.2012, BPA ka lidhur kontratë për marrje me qira të 11,186 m² nga z. A. K. Çmimi i qirasë është përcaktuar 155 lekë për m² në vit, me vlerë totale 1,733,830 lekë. Afati kontratës është një vit, por është shtyrë disa herë dhe vazhdon edhe për vitin 2016. Këtë sipërfaqe toke bujqësore qiradhënësi z. A.K e ka marrë vetë me qira në datën 03.10.2012 nga Komuna “Kuman” Fier. Kontrata e qirasë ndërmjet z. A.K dhe Komunës është lidhur në datën 03.10.2012, dhe vlera e qirasë e përcaktuar në këtë kontratë është 7 lekë për m² në vit. Pra, data e lidhjes së kontratës me Komunën është 3 ditë mëbrapa lidhjes së kontratës me BPA dhe vlera e kësaj kontrate është rritur nga 7 lekë/m² në vit në 155 lekë/m² në vit, ose rreth 2,200%. Në datën 01.09.2012, BPA ka lidhur kontratë për marrje me qira të 6.133 m² tokë bujqësore nga znj. M. G. Çmimi i qirasë është përcaktuar 400 lekë për m² në vit me vlerë totale 2,453,200 lekë. Afati kontratës është një vit, por është shtyrë disa herë dhe vazhdon deri në vitin 2016. Qiradhënësj, për të vërtetuar pronësinë e tokës, në mungesë të certifikatës së pronësisë ka bashkëlidhur kontratat e datës 12.07.2012 për blerjen e kësaj toke nga të tretët. Sipas këtyre kontratave shitjeje, tokën e ka blerë me çmim 489 lekë për m² dhe në vlerën totale rreth 3 milion lekë. Dhe po këtë sipërfaqe tokë bujqësore mbas një muaj e gjysmë i'a jep me qira BPA me çmim 400 lekë /m² në vit me vlerë vjetore 2,453,200 lekë. Pra, çmimi i qirasë është pothuajse i barabartë me çmimin e shitjes së tokës bujqësore në atë zonë. Dhe vetëm vlera vjetore e qirasë së vitit të parë pothuajse mbulon çmimin e blerjes së tokës. Mjaftojnë këto dy fakte për të dalë në konkluzionin se, kostot hidrokarbure janë rënduar fiktivisht, si pasojë e marrjes së tokave bujqësorë me qira mbi çmimet e tregut të qirasë dhe të çmimeve të shitjes së tokave bujqësore në atë zonë. (trajtuar më hollësisht në faqen 74-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Në situacionin e shpenzimeve të tremujorit të parë të vitit 2015, është përfshirë vlera 21,185,260 USD. Këto shpenzime përfaqësojnë pagesën e bërë si penalitet ndaj kompanisë “B P”, si pasojë e ndërprerjes së njëanshme nga BPA, të kontratës për shit-blerjeje të naftës bruto të lidhur me këtë kompani. Kryerja e këtij shpenzimi është në kundërshtim me Aneksi B, neni 2, Pika 2.14 “Shpenzimet ligjore” të marrëveshjes hidrokarbure. Këtë shpenzim si Albetrolit dhe AKBN e kanë identifikuar dhe nuk e kanë njohur si kosto të rikuperueshme. Pavarësisht pretendimeve për mos njohje të kësaj vlere, BPA nuk i ka pranuar këto pretendime dhe nuk ka bërë zbritjen e kësaj vlere në periudhat e më pasme për llogaritje e Faktorit R. Kjo çështje vazhdon të jetë në proces diskutimesh dhe debatesh dhe sipas marrëveshjes mund të shkojë për gjykim në Arbitrazhin Ndërkombëtar (trajtuar më hollësisht në faqen 77-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rritja e kostove hidrokarbure të trajtuar sa më sipër, në shumën e përgjithshme afërsisht 83,740,000 USD, respektivisht, në vitin 2014 për 17,864,000 USD, në vitin 2015 për 47,756,000 USD dhe në 6 muajt e vitit 2016 për 18,120,000 USD, kanë sjell efekte në uljen e Faktorit R, e për pasojë në mungesën e naftës fitim që i takon Alpetrolit. (trajtuar më hollësisht në faqen 78-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN, mbështetur në dokumentacionin justifikues të transaksioneve të referuara më sipër por dhe atyre të ngjashme, të përcaktojë shpenzimet e rikuperueshme në Kosto Hidrokarbure, duke vlerësuar në mënyrë të kujdesshme devijimet anormale nga cmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të përfshira në operacione hidrokarbure dhe rillogarisë Faktorin R.

Brenda datës 31.07.2017

Ç. MASA PËR AUDITIMIN NË VIJIM TË MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE NGA KLSH

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për realizimin e proceseve hidrokarbure nga BPA për vitin 2014, 2015 dhe 2016 KLSH, nuk mundi të llogarisë saktë dhe objektivisht efektet financiare që kanë ardhur nga shpenzimet e kryera, mbi çmimet e tregut, mbi normativat dhe referencat ligjore në fuqi si dhe efekte ekonomike negative që kanë këto shpenzime në buxhetin e shtetit. Për të matrealizuar një auditim më të plotë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit publik, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, kërkohet që:

-AKBN të bashkëpunoi me Albetrolin dhe ME dhe në zbatim të nenit 15.2 të Licensë Marrëveshjes, brenda muajit maj 2017 të marrë zyrarisht nga BPA të gjithë dokumentacionit e hollësishëm të kostove hidrokarbure të realizuar nga BPA për vitin 2004, 2015 dhe 2016, dhe në bazë të tyre të analizojë dhe të llogarisë saktë faktorin R.

Në përfundim të inventarizimit të plotë të këtij dokumentacioni në protokoll-arkivën e AKBN, të njoftohet KLSH, e cila do të kryejë auditimin e këtij dokumentacioni për të përmbyllur procesin e plotë auditues të marrëveshjeve hidrokarbure, me qëllim konstatimin dhe saktësimin e çdo parregullsie, veprimtari të kundraligjshëm, si dhe dëmëve ekonomike që lidhen me to.

Brënda muajit maj 2017

D. KALLEZIM PENAL

Nga ana e Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve të bëhet vlerësimi i shkeljeve të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, veçanërisht për sa i përket shfrytëzimit të burimeve hidrokarbure, për të bashkërenduar m7 pas në ekzistencën e elementeve të ndonjë figure të veprës penale dhe materialet që do përcillen më pas Organit të Prokurorisë në formën e indicies penale, për këto gjetje në këtë fazë të auditimit. Në kushtet e mungesës së plotë të dokumentacionit dhe pamundësisë për të audituar operacionet përkatëse hidrokarbure, auditimi i KLSH do të vazhdojë mbas 6 muajsh.

II. MBI SHFRYTËZIMIN E BURIMEVE MINERARE

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Nga auditimi i kryer në dosjet e monitorimit të subjekteve që zotërojnë leje minerare u konstatua se, Drejtoria Minerare nga inspektimet e kryera në subjekte sipas programeve të kontrollit, ndonëse ka mbajtur akt konstatimi për veprimtarinë e shfrytëzimit minerar, por ky formular nuk është bërë pjesë e dosjes së monitorimit me qëllim krahasimin e volumeve të shfrytëzimit të deklaruara nga çdo subjekt me volumin e punës të matur nga kjo drejtori, me qëllim rakordimin dhe nxjerrjen e diferencave të mundshme, konform nenit 2, të ligjit 10304, datë 15.07.2010 i ndryshuar neni 2 “Përkufizime” pika 24, është përcaktuar se: *"Monitorim minerar dhe postminerar" është vëzhgimi, regjistrimi, mbajtja nën kontroll i ndryshimeve fiziografike të tokës, ajrit, ujërave, sipërfaqësore apo nëntokësore, dhe ekosistemit në përgjithësi, në zonat ku ushtrohet apo është ushtruar veprimtari minerare, në zonat përreth tyre, si dhe marrja e masave parandaluese për fenomenet negative, që shfaqen gjatë apo pas veprimtarisë minerare*".

Ky rakordim, do shërbejë jo vetëm për kontrollin në funksion të ligjit të mësipërm, por duhet të jetë dokument bazë për verifikimin e saktësisë së deklarimeve të shoqërive minerare për volumin

e punës së kryer në fakt, të ardhurat e realizuara nga shitja dhe renta minerare e deklaruar dhe e paguar në buxhetin e shtetit.

Mungesa e rakordimit me Degët Rajonale të Tatim Taksave ku janë të regjistruar subjektet zotëruese të lejeve minerare, ka sjellë si pasojë që për prodhimin e mineralit të nxjerrë dhe të shitur renta minerare të deklarohen në mënyrë të njëanshme nga subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi. Kjo mënyrë veprimi krijon kushte të favorshme për evazion fiskal për të ardhurat tatimore, pasi matjet e kryera nuk vihen në shërbim të ushtrimit të kompetencave që ka AKBN në funksion të pikës 24 të nenit 2, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010.

Në mbështetje të VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore” midis AKBN dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit nr.9689, datë 06.11.2015, marrëveshje që nuk ka funksionuar gjatë periudhës sonë të auditimit.

AKBN ka dërguar dy shkresa nr.1920 dhe nr.1922, datë 12.02.2016, në drejtim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave për të marrë informacion nga këto institucione për prodhimin e shitur brenda vendit dhe të eksportuar. Kjo mënyrë komunikimi ka mbetur e pa finalizuar, pasi edhe në rast se konstatohen diferenca në prodhimin e shitur, të ardhurat e realizuara dhe diferenca në llogaritjen e detyrimeve ndaj buxhetit për rentën e padeklaruar apo të fshehur. *(trajtuar më hollësisht në faqen 87-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN të marrë masa konform VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit të institucioneve të administratës shtetërore” dhe në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit nr.9689, datë 06.11.2015, që bazuar në raportimet periodike 3 mujore apo 6 mujore nga subjektet zotëruese të lejeve shfrytëzuese metalore dhe jo metalore, të realizohet shkëmbimi i informacionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në kohë reale, për të parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal në fushën minerare, informacion mbi lëvizjen e rezervave, volumin stokun e prodhimit, diferencat në vite, fuqinë punëtore reale të subjekteve që zotërojnë leje minerare.

Në vazhdimësi

2. Nga auditimi i kryer me zgjedhje në disa dosje monitorimi, u konstatua se, një numër i konsiderueshëm i subjekteve që zotërojnë leje shfrytëzimi minerar nuk kanë paraqitur fatura tatimore për sasinë e prodhimit të shitur dhe çmimet për njësi, deklarata mujore për shitjet, apo përmbledhëse e librit të shitjeve të deklaruara në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, me qëllim administrimin e dokumentave në dosjen e monitorimit që lidhen me pagimin e rentës minerare, konform VKM nr.547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)”, e cila në ushtrimin e veprimtarisë së saj, krahas detyrave teknike kërkon edhe “respektimin e pagesave të detyrimeve ndaj shtetit konkretisht të tatim taksave”, e cila është edhe një prej kushteve për rinovimin e lejes së shfrytëzimit për periudhën pasardhëse *(trajtuar më hollësisht në faqen 87-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria Minerare të marrë masa që për çdo program pune me objekt shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga zotëruesit e lejeve minerare dhe informacionin vjetor për veprimtarinë e realizuar, monitorimin e aktivitetit të subjekteve që kryejnë shfrytëzimin të mineraleve ndërtimore jo metalore dhe metalore, me qëllim miratimin ose refuzimin e planit vjetor të punës për vitin pasardhës, që krahas dokumentacionit teknik që lidhet me respektimin e lejes shfrytëzuese, të administrojë në mënyrë të detyrueshme edhe treguesit e tjerë ekonomik

financiare si, çmimet e shitjes së mineraleve të vërtetuara me dokumenta tatimore apo doganore, ose me formularin format përmbledhës të librit të shitjeve, për të ardhurat e realizuara dhe të konfirmuara nga strukturat tatimore, si një kusht për llogaritjen e saktë të rentës minerare që duhet të paguhet në buxhetin e shtetit.

Në vazhdimësi

3. Nga auditimi i kryer në dosjet e monitorimeve periodike të subjekteve minerare, vazhdon të mbetet shqetësim i vazhdueshëm për Drejtorinë Minerare, baza e të dhënave që mbahen nga AKBN, MEI, nuk pasqyron saktë datat efektive të lejeve minerare, pasi në këto databasse pasqyrohet si datë efektive të lejeve minerare data e urdhrimit të Ministrisë të MEI dhe jo datën e regjistrimit të tyre pranë QKL-së, duke bërë të paqartë paracaktimin e datës për efekt dorëzimi të dokumentave për miratimin e projekt-programeve-vjetore të punës, e për rrjedhojë edhe penalizmin e subjekteve zotëruese të lejeve minerare. Lista e lejeve minerare nuk pasqyron statusin e disa shoqërive që kanë marrë njoftim për fillimin e procesit të revokimit të lejes, në mënyrë që Drejtoria Minerare të ketë të qartë statusin e tyre në raportimet 3 mujore dhe vjetore, me qëllim miratimin e programit vjetor të punës. Kjo mangësi ka sjellë si pasojë që 26 shoqëri që u janë revokuar lejet minerare të vazhdojnë të figurojnë në regjistër dhe që kryejnë aktivitet prodhues, në kundërshtim me ligjin minerar (*trajtuar më hollësisht në faqen 87-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN dhe MEI të ngrenë grupet e kontaktit dhe të marrin masa për të hartuar një regjistër të përbashkët elektronik të lejeve minerare në mënyrë që ky regjistër të shërbejë si format elektronik edhe për QKL, për t'u përditësuar me çdo ndryshim që kryhet nga AKBN dhe çdo zotërues i lejeve minerare.

Deri në qershor 2017

4. Nga auditimi konstatohet se, në disa raste nuk u gjenden të dhëna për sigurimin e jetës nga aksidentet në punë, dhe në disa raste të tjera nuk është bërë sigurimi i jetës nga aksidentet për të gjithë punëtorët e regjistruar, në kundërshtim me VKM nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”. Duhet theksuar se disa prej subjekteve deklarojnë se kanë siguruar vetëm jetën e ortakut dhe konsulentin e shoqërisë, duke mos deklaruar sigurim jete nga aksidentet në punë për punëtorët e tjerë, ndonëse shoqëria kryen aktivitet nxjerrje dhe prodhim blloqe masive guri, të cilat çuditërisht nxirren nga karriera pa përdorur dinamit, ngarkohen pa asnjë punëtor apo me mjet tjetër, si vinç dhe buldozerë (me justifikimin se puna kryhet me nënkontraktim), që do të thotë se jepet licenca për subjekte që nuk plotësojnë kushtet për numrin e të punësuarve.

Një numër i konsiderueshëm i shoqërive që zotërojnë leje minerare nuk llogarisin koston e prodhimit, sipas strukturës dhe zërave të shpenzimeve, ndër të cilët përmendim zërin pagat e punës dhe sigurimet shoqërorë, si tregues i rëndësishëm i koston, kjo për faktin se, disa subjekte deklarojnë të punësuar 2 deri 3 punonjës, madje në disa raste i gjithë aktiviteti kryhet nga ortakut i vetëm dhe konsulenti i tij, veprime këto që “*nxisin punësimin në të zezë*” dhe evazion fiskal për sigurimet shoqërorë (*trajtuar më hollësisht në faqen 87-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria Minerare të marrë masa që, për çdo program pune me objekt shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga zotëruesit e lejeve minerare dhe informacionin vjetor për

veprimtarinë e realizuar, monitorimin e aktivitetit të subjekteve që kryejnë shfrytëzimin të mineraleve ndërtimore jo metalore dhe metalore, detyrimisht të kërkojë nga çdo subjekt që në miratimin e aktivitetit vjetor të ketë paraqitur edhe strukturën e kostos faktike, e sidomos përcaktimin e saktë të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si një ndër treguesit e rëndësishëm që lufton evazionin në fushën e sigurimeve shoqërore.

Në vazhdimësi

5. Nga auditimi konstatohet se subjektet që zotërojnë minerare për prodhim dhe shfrytëzim “guri gëlqeror” për prodhim çimento, zotërojnë njëkohësisht edhe leje shfrytëzimi për materiale “argjilore” dhe elementë të tjerë përbërës për prodhimin e çimentos, si dhe shoqëri të tjera që zotërojnë leje për shfrytëzim materiale ndërtimi si, “gurë gëlqerorë” dhe “bloqe guri masivë”, nuk kanë deklaruar në AKBN pagesën e rentës minerare në zbatim të nenit 40 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 dhe në disa raste renta minerare nuk është llogaritur mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e prodhimit të çimentos siç përcaktohet në vendimin e Komisionit Ad Hoc të Ministrisë së Financave nr.16365, datë 17.10.2012 “Për miratimin e vlerave referuese sipas normativave teknologjike të produkteve për llogaritjen e rentës minerare” dhe në zbatim të VKM nr.7, datë 04.02.2012 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit të *nevojshëm për përcaktimin e taksës për arkëtimin e rentës minerare*” i ndryshuar me VKM nr.26, datë 27.04.2014 “*Për ngritjen e komisionit Ad Hoc për përcaktimin e listave për vlerat referuese sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale*”, ku janë përcaktuar tarifat rentës për çdo mineral përbërës të çimentos, respektivisht për gurin gëlqeror, argjilën dhe gipsin, sipas të cilës renta minerare është përcaktuar në masën 5% dhe me ndryshimet është ulur në 4 % për njësi të shitur, duke sjellë si pasojë nga 11 shoqëri shmangie fiskale në shumën **56,933,857 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqet 87-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN dhe Drejtorie e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet grupeve të kontaktit dy palësh të rakordojë të ardhurat nga shitja e prodhimit dhe mënyrën e llogaritjes së rentës minerare të deklaruar nga subjekteve me volumet e punës sipas të matjeve fizike të kryera nga AKBN me qëllim evidentimin e diferencave në llogaritjen e rentës dhe arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Deri në qershor 2017

6. Nga auditimi i kryer në regjistrin e hartuar nga “Sektori i Statistikës” për mbylljen e veprimtarisë së vitit 2015, konstatohet se për këtë periudhë janë aktive 20 shoqëri, të cilët kanë prodhuar dhe shitur gjithsej 44,797 m³ “gurë pllakor dekorativë”. Sipas regjistrit të ardhurat e realizuara nga shitja kapin vlerën prej 173,028,691 lekë, ndërsa renta minerare është deklaruar vetëm nga 16 shoqëri në vlerën prej 9,235,693 lekë, ndërsa 4 shoqëri nuk kanë deklaruar pagesë për rentën minerare ndonëse kanë realizuar dhe deklaruar të ardhura nga shitje e prodhimit, veprim i cili është në kundërshtim me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “*Për taksat kombëtare*” i ndryshuar aneksi nr. 2 renta minerare për produktin “*Gurë dekorative pllakorë*” klasifikohet në grupin II “*minerare jo metalike*” me çmim për njësi 6,000 lekë/ton, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën prej **63,600,000 lekë**. (trajtuar më hollësisht në faqen 87-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet grupeve të kontaktit dy palësh të rakordojë të ardhurat nga shitja e prodhimit dhe mënyrën e llogaritjes së rentës minerare të

deklaruar nga subjekteve me volumet e punës sipas të matjeve fizike të kryera nga AKBN me qëllim evidentimin e diferencave në llogaritjen e rentës dhe arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Deri në qershor 2017

7. Nga verifikimi i kryer në regjistrin e hartuar nga “Sektori i Statistikës” për mbylljen e veprimtarisë së vitit 2015, konstatohet se 16 subjekte që zotërojnë leje për shfrytëzim “Gurë pllakorë dekorativë” kanë shitur 34,197 m³ dhe kanë deklaruar rentë minerare në shumën prej 9,235,693 lekë ose 5,30 lekë/m³. Sipas ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, renta minerare për produktin “Gurë dekorative pllakorë” klasifikohet në grupin II “minerare jo metalike” me çmim për njësi 6,000 lekë/ton, renta minerare për prodhimin e shitur në sasinë prej 34,197 m³ me tarifën 6.000 lekë/m³, duhej të deklarohet në vlerën prej 205,182,000 lekë dhe jo 9,235,693 lekë, duke sjellë si pasojë shmangie fiskale në vlerën prej **195.946,037 lekë**. (trajtuar më hollësisht në faqen 87-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet grupeve të kontaktit dy palësh të rakordojë të ardhurat nga shtija e prodhimit dhe mënyrën e llogaritjes së rentës minerare të deklaruar nga subjekteve me volumet e punës sipas të matjeve fizike të kryera nga AKBN me qëllim evidentimin e diferencave në llogaritjen e rentës dhe arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit. Për subjektet që zotërojnë leje shfrytëzimi “gur dekorativ pllakor”, Drejtoria Minerare të marrë masa për ngritjen e një komisioni teknik për të përcaktuar raportin e konvertimit nga njësia 1 m³ “gurë pllakorë dekorativ” që raportohen në programet e aktivitetit shfrytëzues në vlerësimin me njësinë e prodhimit ton me qëllim llogaritjen e rentës minerare.

Deri në qershor 2017

8. Për vitin 2015 janë aktive gjithsej 264 leje minerare për shfrytëzim kromi nga të cilat 3 leje koncensionare respektivisht shoqëritë, A.M, “V.H dhe M K me shoqërinë koncensionare “I .M.I”. Numri më i madh i lejeve minerare është në zonën Bulqizë me 123 leje, ose 47 % e totalit të lejeve për shfrytëzim të mineraleve metalore. Për vitin 2015 prodhimi i kromit nga subjektet e licencuara është 646,139 ton, nga 683,874 ton që ishte në vitin 2014, ose më pak për 5.51 %. Të ardhurat nga renta për këtë vit krahasuar me vitin 2014 janë ulur, si rrjedhojë e uljes së çmimit në bursë. Për vitin 2015 prodhimi i koncentratit të kromit nga të gjithë fabrikat është realizuar në sasinë prej 33,602 ton, nga 50,453 ton që ishte realizuar në vitin 2014, edhe kjo ulje prodhimi ka ardhur si rrjedhojë e uljes së çmimit të shitjes.

Nga auditimi i treguesve të prodhimit deklaruar nga shoqëria “I.M.I.” shpk me lejë minerare nr.677/2, datë 16.09.2002, u konstatuan të dhëna të pasakta të prodhimit vjetor kështu, të ardhurat nga shitja janë deklaruar në vlerën prej 1,140,944 USD, renta minerare në masën 6 % duhet të deklarohet në shumën prej 68,456 USD, ose konvertuar në shumën rreth 8,214,796 lekë dhe jo në shumën prej 4,838,495 lekë që ka deklaruar shoqëria në programin ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqen 108-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet grupeve të kontaktit dy palësh të rakordojë të ardhurat nga shtija e prodhimit dhe mënyrën e llogaritjes së rentës minerare të deklaruar nga subjekteve me volumet e punës sipas të matjeve fizike të kryera nga AKBN me qëllim evidentimin e diferencave në llogaritjen e rentës dhe arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Deri në qershor 2017

9. Me vendimin e KM nr.479, datë 29.06.2011 është miratuar “Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë”, për mineralin e Bakrit është parashikuar që kompanitë minerare të orientohen drejt përdorimit të teknologjive moderne dhe eksploruese si dhe drejt studimeve komplekse që do të shërbejnë si bazë e nevojshme të dhënash për të ulur humbjet e mineralit të nxjerrë nëpërmjet teknologjive të reja, rritjen e rendimentit të prodhimit të mineralit e rrjedhimisht uljen e kostos, rikuperim në pasurim 90-92%; aplikimi i një skeme përpunimi dhe pasurimi që të ketë parasysh marrjen e të gjitha elementeve shoqëruese (Au, Ag, Zn etj.) me efikasitet të lartë e veçanërisht për vendburimin e Munellës. Për këtë vendburim doemos duhet të kërkohet që të realizohet cikli i plotë i bakrit në vend, duke përfshirë të gjitha mineralet e zbuluara dhe nga kompani të tjera në zonë. Sipas të dhënave të monitorimit konstatohet se, jo vetëm nuk është realizuar objektivi afatmesëm por kompanitë koncensionare në fabrikën e pasurimit realizojnë vetëm përpunimin e mineralit me qëllim rritjen e përqindjes së bakrit për njësinë e matjes në ton, duke mos kryer asnjë investim në drejtim të përpunimit të thellë të mineralit, me objektivi prodhimit e arit, argjendit zinkut, dhe elementëve të tjerë përbërës të këtij xeherori që për nga rëndësia konsiderohet pasuri e madhe kombëtare, që nuk ndikon aspak në rritjen e mirëqenies së popullsisë si një prioritet i Strategjisë minerare në Republikën e Shqipërisë *(trajtuar më hollësisht në faqen 108-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN të nxisë dhe të inkurajojë shoqëritë koncensionare dhe të krijojë terren të favorshëm në mënyrë që shoqëritë koncensionare të marrin masa në drejtim të përbushjes së objektivit afatmesëm në përpunimin e mineralit për të kryer investime në drejtim të përpunimit të thellë të mineralit, me objektivi prodhimit e arit, argjendit zinkut, dhe elementëve të tjerë përbërës të këtij xeherori që për nga rëndësia konsiderohet pasuri e madhe kombëtare, për të ndikuar në rritjen e të ardhurave nga renta minerare dhe përmirësimin e mirëqenies së popullsisë si një prioritet i Strategjisë minerare në Republikën e Shqipërisë.

Vazhdimisht

10. Nga auditimi konstatohet se në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar” i ndryshuar, në nenin 57, ku është përcaktuar se: *“Zotëruesit e lejeve minerare, që shfrytëzojnë zonën dhe trupin minerar nëpërmjet galerive nëntokësore të zotëruesve të tjerë të lejeve minerare, duhet të marrin masa që, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të lidhin marrëveshjen, sipas nenit 35 të ligjit, ose të realizojnë hapjen e galerive të tyre”*. Në lidhje me këtë përcaktim Ministri ka nxjerrë urdhrin nr. 255, datë 03.11.2015 dhe ka kërkuar gjithë shoqërive që zotërojnë leje minerare të lidhin marrëveshje servituti me shoqërinë koncensionare “A.C”, në të kundërt do propozohet revokimi i lejes nga MEI. Për këtë Drejtori i Drejtorisë Minerare ka informuar zv/Drejtorin e AKBN, në cilësinë e Kryetarit të komisionit të miratimit të projektprogramit vjetor të punës me shkresën nr.598, datë 22.04.2016 për të njoftuar të gjithë shoqëritë që nëpërmjet lejeve minerare që shfrytëzojnë Krom në zonën “D”, dhe që atakohen me përdorimin e servitutit të lidhin marrëveshje me Shoqërinë Koncensionare “A.C”, në zbatim të kërkesës së saj nr.131, datë 17.03.2016, në rast të kundërt të mos miratohet projektprogrami për vitin në vazhdim. Meqenëse rekomandimi i Drejtorit minerar nuk është marrë parasysh në miratimin e projektprogramit, AKBN me shkresat nr. 8935-8951, datë 12.10.2016 ka njoftuar të gjithë shoqëritë zotëruese të lejeve minerare në këtë zonë të lidhin marrëveshje servituti me shoqërinë Koncensionare “A.C”, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

Në zbatim të kësaj kërkesë konstatohet se, deri sot disa prej shoqërive kanë lidhur marrëveshje servituti me shoqërinë “AC”, ndërsa disa të tjera akoma deri sot nuk i janë përgjigjur shkresës,

pavarësisht se në shkresë specifikohet marrja e masave ekstreme deri në revokim të lejes ndaj çdo shoqërie që nuk lidh marrëveshje servituti.

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN në vazhdim të shqyrtimit të projekt programit të vitit 2017, të marrë masa për respektimin e nenit 57 të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar”, dhe udhëzimit të Ministrit nr. 255, datë 03.11.2015 për mosmiratimin e projektprogramit dhe lejes së shfrytëzimit ndaj çdo shoqërie që nuk lidh marrëveshje servituti për vitin në vazhdim, duke i kërkuar Ministrisë revokimin përfundimtar të lejes minerare.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Auditimi i veprimtarisë minerare u mbështet edhe në informacione të ndryshme të medias së shkruar dhe elektronike që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e mineraleve në zona të mbrojtura nga shteti, kryerjen e veprimtarive shfrytëzuese në zona mineralmbajtëse e sidomos të shfrytëzimit të mineralit të Kromit. AKBN në ushtrimin e funksioneve monitoruese dhe nëpërmjet sinjalizimeve të ndryshme në disa raste ka evidentuar se një numër i konsiderueshëm i subjekteve fizike ndonëse u është revokuar leja e shfrytëzimit, kryejnë veprimtari në kundërshtim me dispozitat ligjore pa licencë në vendburimet minerare e sidomos në minierat e kromit, duke rrezikuar jo vetëm jetën por edhe shmangien e detyrimeve fiskale. Për periudhën objekt auditimi Drejtoria Minerare ka konstatuar disa raste të veprimtaria abuzive të pronës publike, kështu:

-Subjekti privat “B” ka shfrytëzuar në mënyrë të kundaligjshme dhe pa licencë rërë bituminoze në Komunën Portës Fier, për të cilën është penalizuar në shumën 2,000,000 lekë gjobë për kundravajtje administrative dhe është kallëzuar penalisht në Prokurorinë e Rrethit Fier.

-Në kundërshtim me vendimin nr. 2, datë 21.11.2010 në zonën Novaj ish Komuna Bogovë e shpallur “Zonë e mbrojtjes së Veçantë” ushtrojnë aktivitet të paligjshëm në një sipërfaqe prej 1 km² një numër i konsiderueshëm personash fizikë të stimuluar nga persona dhe individë të licencuar për shfrytëzim “guri gëlqeror pllakor”.

Për këto veprimtari të paligjshme AKBN ka njoftuar me shkresa të veçanta Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik në MEI, Ministrinë e Mjedisit, Prefekurat e Qarqeve përkatëse, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtoritë Rajonale të Policisë të rrethit ku kryhet aktiviteti i Paligjshëm.

Për vitin 2015, Drejtoria Minerare për mos respektim të kushteve të përcaktuara me dispozita ligjore nga subjektet dhe shoqëritë e licencuara për shfrytëzim në zonat mineralmbajtëse ka vendosur gjithsej 36 masa administrative “gjobë” në shumën prej 19,000,000 lekë, si dhe 38 masa administrative “propozim për revokim” të lejes minerare metalore (*trajtuar më hollësisht në faqen 112-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN, në bashkëpunim me institucionet e mësipërme të intensifikojnë grupin e Task-Forcës me pjesëmarrjen e punonjësve të organeve kompetentë për të mbajtur në vëzhgim të pandërprerë dhe në bashkëpunim me Policinë Rajonale dhe të Pushtetit Vendor në mënyrë që jo vetëm të evidentohen rastet e shfrytëzimit pa lejë dhe penalizimin e subjekteve por dhe marrjen e masave për sekuestrimin e prodhimit të gatshëm.

Vazhdimisht

III. MBI SHFRYTËZIMIN E BURIMEVE ENERGETIKE

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në shumë monitorime të kontratave koncesionare, lidhur me pamundësinë e përlogaritjes së penalteteve për vonesat në fillimin e punimeve, mosvënien në punë të objektit, monitoruesit paraqesin si argument mungesën e dokumenteve si shkresa të koncesionarit për dërgimin e projektzbatimit për miratim nga autoriteti kontraktor, procesverbali për fillimin e punimeve, dokumentet për testimin e veprës etj. Plotësimi i dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm, nuk ka gjetur zgjidhje, megjithë rekomandimet e KLSH-së të lëna në auditimet e mëparshme dhe rekomandimet periodike të trajtuara në raportet e monitorimit të AKBN-së për MEI si autoriteti kontraktor, deri edhe në zgjidhjen e njëanshme të kontratës. Mungesat në dokumentacionin teknik, juridik e financiar si dhe parregullsitë e shkeljet në zbatimin e kontratave, janë evidentuar nga njëri raport në tjetrin, por në shumë raste AK, si autoriteti vendimmarrës, nuk ka vepruar, nuk ka mbajtur qëndrim ndaj koncesionarit, duke mos e penalizuar nga ana financiare, apo edhe me zgjidhjen e njëanshme të kontratës koncesionare. Në disa raste, kjo përbën një mungesë rakordimi në punën e institucionit qendror (MEI-t) me institucionet e varësisë (AKBN). Penaltetet e përlogaritura në raportet e monitorimit të AKBN, për vitin 2015, janë rreth **8.2 miliard lekë**, për tremujorin e dytë 2016 janë rreth **1.2 miliard lekë**. Për zbatimin e penalteteve AK nuk ka njoftuar AKBN për vendimin që ka marrë. Kjo ka bërë që të mos zbatohen kushtet e kontratave, koncesionari të vazhdojë me shkelje duke mos realizuar detyrimet dhe puna e AKBN në rolin e monitoruesit të mos ketë efektivitetin e duhur (*trajtuar më hollësisht në faqen 112-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) si AK, pasi të studiojë rekomandimet e AKBN shprehur në raportet tremujore të monitorimit, të bëjë saktësimin e shifrave lidhur me penaltetet për moszbatim të kushteve të kontratës, në përputhje me nenin 23 të Kontratës Koncesionare, të përgatisë aktet administrative për arkëtimin e këtyre vlerave.

Për kontratat koncesionare të cilat nuk kanë filluar të zbatohen, ku shoqëritë koncesionare nuk kanë filluar ndërtimin e HEC-eve, megjithëse afatet kanë kaluar çdo kufi, MEI të vlerësojë e situatën ku ato ndodhen e të vendos për zgjidhjen e njëanshme të këtyre kontratave.

Në vijimësi

2. Në shumë objekte, është filluar punë duke mos pasur dokumentacionin e domosdoshëm teknik e ndërtimor përkatës, si; leje ndërtimi, licenca të ndryshme, procesverbale për fillimin e punimeve etj; ose punohet pa pasur dokumente ekonomike e financiar (pa fatura tatimore, siguracione, situacione, pasqyra financiare etj). AKBN për të plotësuar detyrën e vetë, duhet të kërkojë rrugëzgjidhje, siç është edhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore. Bashkëpunimi me Inspektoratin Ndërtimor, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim Taksave, OSHEE, Agjencia Kombëtare e Mjedisit etj, kanë si objekt të veprimtarisë së tyre, probleme që i shërbejnë plotësimit të kërkesave të kontratave koncesionare, siç është kontrolli për dokumentacionin teknik, ligjor apo financiar. Prandaj është i domosdoshëm bashkëpunimi institucional, i cili në përgjithësi ka munguar. Ky bashkëpunim nuk është në dëshirën e palëve, por detyrim i përcaktuar nga VKM nr.867, date 10.12.2014 “Për Procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”. Në këtë Vendim përcaktohet: “Çdo institucion i administratës shtetërore ka të drejtë që, nëpërmjet kësaj procedure, të kërkojë nga institucionet e tjera të administratës shtetërore që t’i sigurohen të dhëna, informacione apo çdo lloj ndihme tjetër, të cilat janë të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale të tij”.

AKBN ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), me nr. Prot. 9689, date 6.11.2015, sipas së cilës do të bashkërendohen veprimet, do të ketë shkëmbim informacioni, përfshirë atë në kohë reale, mbështetjen reciproke për të

parandaluar dhe luftuar aktivitetet e paligjshme dhe evazionin fiskal, në funksion të administrimit, monitorimit dhe përmirësimit të gjithë veprimtarive, në fushën minerare, hidrokarbure, hidroenergjetike etj. Për plotësimin e detyrimeve dokumentare të koncesionarëve në fushën energjetike, në nenin 2, pika 2 të Marrëveshjes, theksohet se, DPT jep informacion për kërkesat e AKBN, në lidhje situacionet e punimeve, të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes dhe të vendosin në dispozicion treguesit mbi AQT për shoqëritë koncesionare për ndërtimin e HEC-eve. Nga auditimi konstatohet se, kërkesat e Marrëveshjes nuk janë zbatuar, AKBN nuk i ka shfrytëzuar ata në dobi të punës monitoruese (trajtuar më hollësisht në faqen 112-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN si institucioni monitorues, të kërkojë lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe, funksionimin real të bashkëpunimit me institucionet e tjera si Inspektoratin Ndërtimor, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, OSHEE, Agjencia Kombëtare e Mjedisit etj, për zbatimin e detyrave të saja funksionale. Bashkëpunimi të realizohet në forma e rrugë efektive si nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve në kohë reale për problemet që preokupojnë palët, funksionimin e grupeve të përbashkëta për kontrollin dhe ndjekjen e problemeve që u takojnë atyre, nxjerrjen e konkluzioneve dhe vendimin për veprim, me qëllim përmirësimin e situatës.

Në vijimësi

3. Në raportet e monitorimit të kontratave për HEC-et që janë në prodhim, ka konstatime të përgjithshme, nuk trajtohen probleme specifike të shfrytëzimit të veprave dhe realizimit të detyrimeve që kanë koncesionarët ndaj shtetit si: fuqia e instaluar sipas kontratës, projektit të zbatimit të miratuar dhe fuqia e vendosur realisht nëpërmjet aggregateve, makinerive e pajisjeve të instaluar në objekt; niveli i energjisë elektrike të prodhuar, mosrealizimet dhe shkaqet (analizë e hollësisht); monitorimi në vazhdimësi (jo vetëm në fund të vitit), për realizimin e detyrimeve ndaj shtetit, në formën e fee koncesionare; shfrytëzimi optimal i burimeve ujore; respektimi i rregulloreve gjatë shfrytëzimit të HEC-eve; rehabilitimi i ambientit, plotësimi i detyrimeve sipas kushteve të përcaktuara në Kontratën, etj (trajtuar më hollësisht në faqen 112-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Grupet në terren, për monitorimin e kontratave koncesionare të HEC-eve të vënë në shfrytëzim, të përqendrohen më shumë në zbatimin e detyrave teknike të prodhimit të energjisë elektrike, transmetimit dhe shitjes, duke analizuar marrëdhëniet e koncesionarëve me institucionet si OSHEE dhe KESH sha.

Monitorimi të përfshijë analizën e gjendjes financiare të shoqërive koncesionare që zotërojnë vepra në shfrytëzim, duke e krahasuar me detyrimet sipas planeve të biznesit, për të krijuar kushte për ecuri të sigurt të koncesionit, deri në mbarimin e afatit sipas kontratës koncesionare.

Në vijimësi

4. Konstatohet nga monitorimet në terren, se në disa raste, përfaqësuesit e koncesionarit nuk marrin pjesë në këtë procedurë (megjithëse njoftohen zyrtarisht), ose nuk firmosin aktin e monitorimit, duke mos u njohur drejtpërdrejtë me problemet e konstatuar nga punonjësit e AKBN. Kështu, nga monitorimet e 3 mujorit të dytë të vitit 2016, në 23 raste kanë firmosur përfaqësuesit e koncesionarit, duke u njohur me problemet e trajtuara, ndërsa në mbi 20 monitorime të tjera nuk kanë qenë të pranishëm ose përfaqësuesit e koncesionarëve kanë

refuzuar të firmosin (*trajtuar më hollësisht në faqen 112-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN të bashkëpunojë me Autoritetin kontraktor (MEI), për të bërë të përgjegjshëm koncesionarin që të kuptojë se bashkërendimi i veprimeve monitoruese është interes i përbashkët i palëve dhe detyrim i kontratës koncesionare. Në të kundërt, MEI të rishikojë kontratën, duke futur në të detyrimin e koncesionarit për t'iu përgjigjur AKBN-s lidhur me zbatimin e procedurave të monitorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Konstatohet se, pothuajse në të gjitha rastet, mbas përfundimit të ndërtimit, nuk janë zbatuar rregullat për kryerjen e testimit të veprave, përpara hyrjes së HEC-eve në prodhim. Nga 29 HEC-et e ndërtuar në periudhën e viteve 2014, 2015, punonjësit e AKBN kanë marrë pjesë në testimin e vetëm dy HEC-e (HEC-in “Gurshpat” në vitin 2014 dhe “Lubalesh” në vitin 2015). Edhe në këto dy raste të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të AKBN në testim, nuk janë përfunduar procedurat, nuk janë përgatitur aktet e testimit. Pavarësisht pengesave e vështirësive, kryerja e testimit me pjesëmarrjen e palëve, duke përfshirë dhe AKBN, është një faze dhe kërkesë e domosdoshme për t'u zbatuar, kërkesë e përcaktuar qartësisht në kontratat koncesionare. Nga AK dhe AKBN konstatohen zvarritje të procedurave, deri sa përfundojnë afatet e parashikuara në kontratë për kryerjen e testimit (*trajtuar më hollësisht në faqen 112-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN, mbas njoftimit që merr nga AK, të tregohet e gatshme dhe t'i përgjigjet në kohë kërkesave të koncesionarëve për të marrë pjesë në testimin e hidrocentraleve të vënë në shfrytëzim. Për HEC e vënë në punë dhe koncesionarët kanë bërë vetëtestim, AKBN t'u kërkojë atyre dokumentacionin, duke bërë vlerësimin e tij në raport me kushtet e kontratës koncesionare. Për HEC-et e vënë në prodhim dhe nuk është bërë testimi i veprave, të përgatiten në mënyrë të detajuar Raportet Përfundimtare të vlerësimit të HEC-eve, më qëllim të paraqitet gjendja reale e tyre, me të gjithë treguesit.

Në vijimësi

6. Në procesin e ndërtimit të veprave, për disa kontrata koncesionare janë bërë ndryshime në skemën e shfrytëzimit të HEC-eve, në raport me detyrimet sipas kontratave koncesionare dhe projekteve të zbatimit, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor, duke mos u shoqëruar me shtesë kontrate nga palët. Mungesa e shtesave të kontratave, për rastet e ndryshimeve në madhësinë e investimit, fuqisë të vendosur, prodhimin e energjisë elektrike, përgjegjësia është e Autoritetit Kontraktor. Por, edhe AKBN ka përgjegjësi, pasi raportet e monitorimit për kontratat që kanë ndryshime në treguesit e mësipërm, nuk janë reale pasi nuk i referohen shifrave të ndryshuara pas oponencës teknike të një projektzbatimi të rishikuar, në disa raste ato janë miratuar nga edhe nga AK. Ndryshimet e fuqisë së vendosur e në prodhimin e energjisë elektrike, kur ato janë në rritje, shoqërohet me rritje të detyrimeve që kanë shoqëritë koncesionare lidhur me sasinë e energjisë elektrike që duhet t'i jepet shtetit në formën e Fee koncesionare dhe në masën e penaliteteve (kur ka të tilla).

Nga auditimi i dokumentacionit të koncesioneve, rezulton se **në mbi 80 raste** kontratat koncesionare kanë pasur ndryshime, si për treguesin e fuqisë të vendosur, kryesisht në rritje, shoqëruar në raste të veçanta me rritjen e prodhimit të energjisë elektrike. Si rezultat edhe

detyrimet e koncesionarëve ndaj shtetit në formën e Fee koncesionare, kanë pësuar ndryshime në rritje, por ata nuk llogariten gjatë monitorimit të AKBN, me pretekstin e mungesës të shtesave të kontratave.

Duke iu referuar të dhënave të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2015 dhe treguesve që ka AKBN (sipas KK), rezultojnë mospërputhje të treguesve të KK me atë të licencuar, për kapacitetin në disa HEC-e. Ndaj koncesionarëve që nuk kanë realizuar fuqinë e instaluar, nuk janë propozuar e marrë masa penalizuese, të parashikuara në nenin 23 të Kontratës Koncesionare (*trajtuar më hollësisht në faqen 112-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të bëhet evidentimi i saktë për të gjitha objektet (HEC-et) e kontratave koncesionare, të cilat kanë pësuar ndryshime të treguesve si vlera e investimit, ana teknike të funksionimit të veprave, fuqia e instaluar, sasia e prodhimit të energjisë elektrike etj. AKBN të bëjë rakordimet me AK për shtesat e kontratave të nënshkruara midis palëve në rastet e ndryshimeve, duke bërë vlerësimin për ato raste që akoma nuk janë bërë shtesa të kontratave ndërmjet AK dhe koncesionarëve.

Të bëhen raportet e vlerësimit të objekteve energjetike mbi bazën e treguesve të ndryshuar, mbi bazën e oponencës teknike të miratuar, mbas rishikimit të projektzbatimeve. Monitorimi i dokumentacionit juridik, teknik e financiar të bëhet mbi bazën e treguesve të shtesave të kontratave të miratuara nga palët. Po ashtu edhe prodhimi i energjisë elektrike dhe detyrimet që koncesionarët kanë ndaj shtetit të bëhet mbi bazën e këtyre treguesve të ndryshuar e të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Nga auditimi i dokumentacionit juridik për funksionimin e disa shoqërive koncesionare, është konstatuar se, në ekstraktin historik të QKR, në objektin e aktivitetit të tyre, nuk përfshihet procedura e transferimit të HEC-eve tek AK, me përfundimin e afatit të koncesionit sipas Kontratave. Kjo parregullsi është konstatuar në ekstraktet historike të shoqërive “E”, me nr. NIPT-i K....., për marrjen me koncesion të 22 HEC-eve vendor, me marrëveshje të formës ROT; “ E”, me NIPT nr. L..... për ndërtimin-operimin-transferimin e HEC-eve “Domje, Kolesjan e Lajthia, në dokumentin e QKR për shoqërinë “P” dhe “E” për dhënien me koncesion të HEC-it “P 1”; të shoqërisë “R E”, për ndërtimin e HEC-eve Cemerica 1,2,3; të shoqërisë “A K” për rehabilitimin e HEC-it “Xhyrë” etj.

Në objektin e veprimtarisë të këtyre shoqërive koncesionare përcaktohet se: “...përfshihet financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike”. Në nenin 8, pika 1 të KK është përcaktuar: shoqëria koncesionare do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj vetëm financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës tek autoriteti kontraktues. Mos përfshirja në objektin e veprimtarisë të shoqërive aksionare, të fazës së transferimit të HEC-eve shtetit shqiptar, mbas përfundimit të afatit të dhënies me koncesion, është në kundërshtim me ligjin për koncesionet dhe me detyrimet e përcaktuara në kontratën koncesionare të nënshkruara nga palët Autoriteti Kontraktor dhe koncesionari (*trajtuar më hollësisht në faqen 112-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

AK dhe AKBN të rishikojnë dokumentacionin ligjor të paraqitur nga koncesionari, duke kërkuar rregullimin e saktësimin e tyre, për rastet kur ato nuk përputhen me ligjin e koncesionave dhe përmbajtjen e kontratës koncesionare, duke kërkuar nga institucionet përkatës rregullimin ligjor. Për shkeljet e paraqitura më sipër e të tjera të kësaj natyre, AK t'i drejtohet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për të bërë rregullimet ligjore në objektin e veprimtarisë të shoqërive koncesionare, paraqitur në dokumentet ekstrakt i thjeshtë dhe historik.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Për vitin 2014, prodhimi i energjisë elektrike është realizuar me 733.5 milion këh, kundrejt 950 milion këh prodhimi sipas kontratave koncesionare ose realizimi rreth 77 %, me një diferencë rreth 216.4 milion këh, që përbën energjinë elektrike të munguar. Meqenëse koncesionarët nuk kanë paraqitur argumente lidhur me mosrealizimin e prodhimit, sipas nenit 23, pika 2, germa “a” të KK, penalizohen me 5 % të vlerës së përealizuar të prodhimit të energjisë elektrike. Në këtë situatë edhe Fee koncesionare llogaritet në përqindje mbi sasinë e prodhimit të parashikuar në kontratë. Për vitin 2014, për mosrealizimin e prodhimit dhe të diferencës së Fee koncesionare, është llogaritur një penaltitet në vlerën e rreth **178.8 milion lekë**.

Për vitin 2015, është prodhuar 824,863,392 këh dhe është llogaritur një Fee koncesionare 23,046,576 këh dhe në vlerë 179,522,010 lekë. Prodhimi i munguar i energjisë elektrike është rreth 271 milion këh ose rreth 2 miliard lekë. Për mosrealizimin e prodhimit të energjisë elektrike për faj të koncesionarit dhe të Fee koncesionare sipas kontratës, prodhuesit janë penalizuar me rreth **140 milion lekë**.

Theksojmë se detyrimi ndaj shtetit në formën e Fee koncesionare dhe e diferencës nga mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike, do të ishin më të mëdha (për rrjedhojë edhe vlera e penaltitetit), në qoftë se krahasimi do të bëhet me prodhimin e parashikuar sipas treguesve të oponencës teknike të projektit të zbatimit të rishikuar apo të fuqisë të licencuar nga ERE, pasi në shumë raste ka pasur rritje dhe nuk janë reflektuar në kontrata shtesë (*trajtuar më hollësisht në faqen 112-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Monitorimi lidhur me zbatimin e kushteve të Kontratave Koncesionare bazë dhe shtesave të kontratave, të bëhet për të gjithë koncesionarët, duke përlllogaritur detyrimet nga momenti i vënies në punë të HEC-ve.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Lidhur me zbatimin e VKM nr.1055, date 22.10.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, nga auditimi i dokumentacionit, u konstatuar se disa shoqëri koncesionare, nuk kanë bërë pagesën e tarifës të përlllogaritur për kryerjen e oponencës teknike. Ky veprim është kryer në kundërshtim me piken 2, të nenit 8, të rregullores “Për funksionimin e grupit për kryerjen e OT të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me koncesion në AKBN”, ku është theksuar se subjektet kanë detyrimin, të bëjnë pagesën sipas tarifave përkatëse, ***para se të kryhet oponenca teknike në AKBN***. Në periudhën para vitit 2014, konstatohet raste të kryerjes së oponencës pa bërë pagesën e tarifës si për HEC-et e Prroit Trebisht, HEC-in Dardhë të shoqërisë “E”, HEC-it “Pobreg”, HEC-et “Zalli i Okshtunit”, etj. Në vitin 2015 janë 5 shoqëri që nuk kanë bërë pagesën tarifës për oponencën teknike. Për 8 mujorin e vitit 2016, janë 4 shoqëri koncesionare që nuk kanë bërë pagesën e tarifës për kryerjen e oponencës teknike të projekteve të zbatimit, me një **vlerë 9,139,635 lekë**. Po kështu nga rilllogaritjet e tarifave të oponencës për HEC-et me vlerë mbi 300 milion lekë (sipas VKM nr.444) tre shoqëri nuk kanë kryer pagesën e

diferencës, në vlerën **875,618 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqen 134-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtoria Hidroenergjetike, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të bëjë rakordimet për shoqëritë koncesionare që janë debitor ndaj AKBN për moskryerjen e pagesave të tarifës koncesionare.

Drejtoria Hidroenergjetike të bllokojë oponentat teknike të bëra nga Grupi i Oponencës, për projektzbatimet bazë dhe të rishikuar të HEC-eve, të atyre shoqërive që nuk kanë kryer pagesën e vlerës së përlllogaritur të tarifës.

Spektori i Financës të bëjë kontabilizimin e detyrimeve debitorë të shoqërive dhe të sigurojë shpërblimin e dëmit në shumën **10,015,245 lekë**.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NGA MOS HYRJA NË BUXHET E TË ARDHURAVE

1. Sipas evidencave të AKBN, deri në gusht 2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI), ka lidhur gjithsej 183 kontrata koncesionare për ndërtimin e 525 HEC-e, me fuqi totale të instaluar rreth 2165 MW dhe prodhim mesatar vjetor të energjisë elektrike rreth 9342,3 GW. Deri në tremujorin e tretë të vitit 2016, janë në prodhim 123 HEC-e; janë në proces ndërtimi ndërtim 40 HEC-e; nuk ka filluar ndërtimi i 362 HEC-e. Prodhimi vjetor i energjisë elektrike, për HEC-et e ndërtuar dhe vënë në shfrytëzim, përfaqëson rreth 15.3 % të prodhimit total të 525 HEC-eve të parashikuar për ndërtim. Ndërsa rreth 70 % e HEC-eve të parashikuara për ndërtim dhe prodhim, akoma nuk kanë filluar të ndertohen, të cilat përfaqësojnë e rreth 65% të fuqisë totale të planifikuar. Mosrespektimi i afateve të përcaktuara në kontratat koncesionare, për ndërtimin dhe vënien në shfrytëzim të HEC-eve, do të thotë mungesë e prodhimit të energjisë elektrike të planifikuar, pamundësi e plotësimit të nevojave të ekonomisë me prodhim të energjisë elektrike të vendit dhe shpenzimi i fondeve të shumta për importimin e saj nga vendet e tjera. Nisur nga kjo, bazuar në afatet e përcaktuara në çdo kontrat për ndërtimit e këtyre HEC-eve, dhe në treguesit e prodhimit të realizuar apo të përealizuar nga çdo HEC dhe koncesionar për vitet 2014, 2015, dhe tre mujorin e parë të vitit 2016, duke u mbështetur dhe marrë për bazë edhe vlerat e llogaritura nga vetë AKBN, llogaritëm penaltitetet për vonesat e ndërtimit për mos vënien në prodhim të HECE-ve dhe penaltitetet për fee koncesionare (tarifën e koncesionit) të munguar dhe të pa hyrë në buxhetin e shtetit. Kështu, nga përlllogaritjet e bëra rezultoi se:

-Lidhur me vonesat në ndërtimin dhe mosvënien në prodhim të 362 HEC-ve llogaritet një penaltitet për vitin 2015 rreth 8.2 miliard lekë dhe për 6 mujorin e vitit 2016 rreth 1.2 miliard lekë.

-Lidhur me mungesën e prodhimit apo mos realizimin e energjisë elektrike bazuar në nenet 23, të kontratave koncesionare në të cilat përcaktohet penaltitet në masën 5% të vlerës së prodhimit të energjisë të pa realizuar, llogaritet penaltitet për fee koncesionare të munguar rreth 178.8 milion lekë për vitin 2014 dhe 140 milion lekë për vitin 2015.

Vlera totale e penaltiteteve të llogaritura dhe të pa hyra në buxhetin e shtetit, si pasojë e mos respektimit të kushteve të përcaktuara në kontratat koncesionare llogaritet rreth 9.72 miliard lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

AKBN dhe ME, të marrë masa, të analizojë me grup pune të përbashkët, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mospërdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike si pasojë e mos përfshirjes në buxhetin e shtetit të penaliteteve **në vlerën rreth 9.72 miliard lekë**.

Menjëherë

IV. VLERËSIMI NGA ORGANI I PROKORORISË

Krahas indicies penale për shkeljet e konstatuara në auditimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure i gjithë ky Raport Përfundimtar Auditimi sëbashku me rekomandimet përkatëse do të përcillen për vlerësim në Organin e Prokurorisë.

V. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë AKBN dhe ME për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të monitorimit dhe mbikëqyrjes së shfrytëzimit sa më mirë të burimeve natyrore, në përputhje me parimet e ekonomikitetit, efijencës dhe efektivitetit në shërbim dhe në dobi të popullit shqiptar.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH do të kryejmë auditim të veçantë për marrëveshjet hidrokarbure, veçanërisht porsa i përket plotësimit të rekomandimeve për përcaktimin e saktë të faktorit R.

Raporti Përfundimtar i Auditimit sëbashku me rekomandimet përkatëse i përcillen: Komisionit Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregëtin dhe Mjedisin, Kryeministrit, Ministrin të Energjetikës dhe Industrisë dhe Ministrin të Financave.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm dhe Drejtoria Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R